



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2024, ora 09:30

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE VII

Drejton tryezën: Nirvana Deliu

Rendi i ditës:

Parandalimi i pastrimit të parave dhe korrupsionit transnacional”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj dhe Esmeralda Dida.

Të ftuar:

Skerdian Kurti, Ledion Shahini, Saimir Boshnjaku, **Ervin Koçi**, Gentian Ndoi, Besfort Lamallari, Klajd Karameta, Deniz Deralla, Ardita Seknaj, Sotirag Dhamo, Adriana Ristani, Idriz Haxhiaj, Aleksandër Maskoviç, Zoran Jcheve, Tibor Draskoviç, Christofer Toyn, Sasha Trpchevski, Isabele Thomas Delic, **Ervin Kaçi**, Donjet Gjoka, Artan Shiqerukaj, Agim Myslia, Janos Kepi, Ilirjana Tabaku, Reinalo Pipiria, Lorena Cadri, Arjan Dyrmishi, Ernis Xhelilaj, Lorina Salaj, Klodian Mema, Amarildo Allku, Alen Dervishi, Martilda Shatro, Enkeleda Kuçi, Helidon Bele, Kozeta Pinari, Anxhela Bakiasi, Sefeda Lazaj, Avjerina Bazaj, Anxhela Xhaha, Esmeralda Metho, Tea Qose, Livia Sejdini, Mariza Tola, Xhenifer Lila, Mei Kalia, Elvisa Baçi, Iralda Skura, Klerisa Cekani, Rovenia Pregja, Refat Sulejmani, Malvina Sinari, Marjeta Mazreku, Brixhilda Kostare, Diana Stello, Reald Keta dhe Genti Çani.

HAPET MBLEDHJA

Nirvana Deliu - Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendësministra,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve shtetërore, kolegë, bashkëpunëtorë nga shoqëria civile, nga sektori privat, por edhe nga universitetet, ju uroj mirëseardhjen në këtë takim të radhës së komisionit të posaçëm parlamentar për antikorrupsionin!

Tema e takimit të sotëm është lufta kundër pastrimit të parave dhe korrupsionit transnacional.

Kam kënaqësinë që panelin sot ta ndaj me dy kolegë dhe bashkëpunëtorë të mi, me të cilët kam punuar për realizimin e këtij raporti, zotin Skerdian Kurti dhe zotin Ledion Shahini, të cilët do të ndajnë më në detaje të gjitha gjetjet e raportit në lidhje me temën që kemi sot në fokus të diskutimit.

Në fakt, puna është bazuar në dokumente strategjike, në raporte të ndryshme, por edhe në bashkëpunim shumë të frytshëm dhe pozitiv me institucionet shtetërore, sidomos me Agjencinë e Inteligjencës Financiare, të cilën dua ta falënderoj për të gjithë kontributin, rekomandimet dhe inputet që na ka dhënë gjatë të gjithë kohës që kemi punuar për këtë raport!

Ndërkohë, nuk jemi ndalur vetëm në legjislacionin tonë dhe strategjitë kombëtare, por jemi fokusuar edhe në raportet e organizmave ndërkombëtarë në lidhje me pastrimin e parave, sidomos kemi pasur në fokus vetë procesin e integritetit evropian të vendit tonë, duke u dedikuar një vëmendje të veçantë raporteve të Komisionit Evropian, raportit të shtetit të së drejtës apo dhe *screening report* për grupkapitullin e parë. Në fakt, kur flitet për luftën kundër pastrimit të parave, ajo gjithmonë lidhet me Kapitullin 24, që është pjesë e grupkapitullit të parë “Themeloret”, por si fushë shumë e ndërlidhur dhe e komplikuar ajo prek edhe çështje dhe tematika të tjera, të cilat Skerdiani dhe Ledioni do t’i analizojnë më në detaje.

Ndërkohë, në fokus kanë qenë edhe dokumentet strategjike të realizuara nga shteti shqiptar, sidomos udhërrëfyese për shtetin e së drejtës, por edhe agjenda e reformave në kuadër të Planit të Rritjes, të gjitha këto dokumente, që kanë në fokus rrugëtimin tonë drejt BE-së dhe realizimin e reformave, sidomos për çështjet themelore dhe shtetit të së drejtës.

Një element i rëndësishëm, që dua ta përmend dhe nuk do të zgjatem shumë në fjalën time, është fakti se kur flasim për luftën kundër korrupsionit, me hapjen e negociatave të grupkapitullit

të parë, vetëm disa javë më parë, më 16 tetor, u pa se lufta kundër korrupsionit u vendos si një kriter i ndërmjetëm, i cili përcakton të gjithë progresin që duhet të bëjë vendi për Kapitullin 24, por, ashtu siç është thënë, dhe tashmë jeni në dijeni, progresi që do të kemi për këto grupkapituj të parë, pra për 5 kapitujt e famshëm themelorë, do të ndikojë në progresin e të gjithë procesit të negociatave të integritetit evropian. Kështu që, kjo nënkupton se është një fushë me shumë rëndësi, me shumë prioritet që ka sfida, por asgjë nuk është e pamundur nëse vullneti dhe puna janë aty.

Pa humbur kohë fjalën po ia jap zotit Skerdian Kurti.

Skerdian, ju do të fokusoheni më shumë te pjesa e legjislacionit dhe e kuadrit ligjor në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave në Shqipëri.

Faleminderit!

Skerdian Kurti – Faleminderit, Nirvana!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar të pranishëm,

Tema e sotme është e rëndësishme dhe i përket një prej komponentëve të shtyllës së dytë të këtij komisioni, që ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit.

Fillimisht dua të shpjegoj pak lidhjen që ka pastrimi i parave me korrupsionin. Kur flasim për korrupsionin, pavarësisht se kjo gjë është diskutuar edhe në tryezat e mëparshme, duhet të kemi parasysh që është një fenomen, është një grup veprash penale, dhe tiparet e korrupsionit janë të ndryshme, karakteristikat e tij janë të ndryshme, dhe secila prej këtyre grupveprave penale kërkon luftë specifike më vete. Pra, nuk është i njëjtë korrupsioni pasiv me korrupsionin aktiv, nuk është i njëjtë korrupsioni i kryer nga punonjësit e administratës me korrupsionin e kryer nga krimi i organizuar, e kështu me radhë.

Diçka tjetër që dua të theksoj lidhet me faktin se korrupsioni nuk është problem vetëm i vendit tonë. Korrupsioni ka qenë dhe është problem mbarëbotëror, i pothuajse të gjitha shteteve, por ka një veçori dhe specifikë, që përhapet dhe zhvillohet sipas karakteristikave të vendit që ai përfaqëson ose më saktë që ai zhvillohet. Kështu që, përsëri lufta kundër korrupsionit, në vartësi dhe të specifikave që paraqet vendi ynë, është ende më e vështirë.

Sa u përket masave të luftimit të korrupsionit, unë i karakterizoj në tri nivele: parandaluese, ndëshkuese dhe vështirësi në gëzimin e të ardhurave.

Parandaluese do të thotë që të merren masa, sidomos të nivelit ligjor dhe institucional, të cilat bëjnë të mundur që të mos realizohet korrupsioni; ndëshkuese kanë të bëjnë me ato masa që

merren me ndëshkimin, duke frikësuar atë pjesë të popullsisë, e cila është e prirur për të kryer korrupsion, me qëllim që ata të heqin dorë nga kryerja e kësaj sjelljeje të jashtëligjshme. Nëse dy të parat nuk mund të realizohen për shumë arsye, hapi i fundit është vështirësia në gëzimin e të ardhurave kriminale që gjenerohen nga korrupsioni, dhe këtu e gjen veten, pikërisht, pastrimi i parave. Supozojmë që masat parandaluese nuk kanë dhënë efekt dhe janë kryer këto vepra penale, edhe ndëshkimi nuk u bën dobi atyre që e kanë, të themi, në gjen që të merren me korrupsion, ose, nëse nuk e kanë në gjen, janë të ndikuar nga rrethana të caktuara për t'u përfshirë në korrupsion, atëherë t'u heqim mundësinë ose t'i privojmë që t'i gëzojnë ato para, të cilat i kanë fituar nëpërmjet korrupsionit. Pikërisht, këtu jemi në kuadër të pastrimit të parave, sepse ata do të kërkojnë gjithmonë që t'i pastrojnë këto para.

Nga të dhënat e SPAK-ut, të paktën nga raportet e SPAK-ut, vlerësohet se pastrimi i produkteve ose pastrimi i parave të pista, që krijohet përmes korrupsionit është mjaft kompleks.

Vlen të theksohen dy dukuri ose një lidhje e dyfishtë ndërmjet korrupsionit dhe pastrimit të parave.

E para është fakti që korrupsioni krijon para, të cilat do të shërbejnë për pastrimin e parave, por, nga ana tjetër, pastrimi i parave do të shërbejë si një burim për të incentivuar korrupsionin. Por, nëse e para është shumë e vështirë, e dyta është pak më e lehtë. Pse? Sepse ka të bëjë me atë që ne zakonisht e quajmë korrupsion aktiv. Korrupsioni aktiv është më pak i dëmshëm se korrupsioni pasiv, pasi varet nga integriteti dhe figura e punonjësve të administratës publike.

Gjithsesi, fenomenin e pastrimit të parave, i cili është një fenomen shumë i rëndësishëm, dhe ne e shikojmë në kuadër të frenimit të korrupsionit, pa u hyrë në detaje problemeve që ai mund të sjellë, sepse problemet që ai mund të sjellë janë të shumta, ne e ndajmë në dy kategori: pastrimi i parave që bëhet nga individët dhe pastrimi i parave që bëhet nga krimi i organizuar. Pastrimi i parave që bëhet nga individët lidhet më së shumti me kryerjen e veprave penale, të cilat gjenerojnë produkte kriminale, që kërkojnë pastaj, nëpërmjet mënyrave të ndryshme, që të bëjnë riciklimin e këtyre parave. Vështirësia në këtë rast ka njëfarë niveli, por nuk është aq e madhe. Sa i përket pastrimit të parave që bëhet nga krimi i organizuar, këtu problemet janë ende më të mëdha, pasi edhe pasojat që do të ketë shoqëria janë të mëdha, sepse ndikon në ekonomi, në zhvillime politike, në sigurinë kombëtare, është i drejtpërdrejtë dhe tepër i madh.

Atëherë, na lind për detyrë që të marrim edhe masat e duhura për të realizuar parandalimin e pastrimit të parave. Masat që ndërmerren për të parandaluar fenomenin e pastrimit të parave, ne

pasi i kemi parë të gjitha raportet, të cilat ne i kemi studiuar, e vënë theksin te masat me karakter ligjor dhe masa me karakter institucional. Të gjitha raportet theksojnë pak a shumë të njëjtën gjë: masat me karakter ligjor janë pothuajse në nivelin e duhur sa i përket Shqipërisë, por ajo çfarë mungon është zbatimi i ligjit, ose diçka që nuk shkon në lidhje me masat me karakter institucional.

Për sa u përket masave me karakter ligjor, raporte të ndryshme, unë do të citoj këtu MONEYVAL, FATF, progresraporti i Komisionit Europian për Shqipërinë, *screening*, të gjitha këto janë të vitit 2023, vlerësojnë faktin që ka një progres në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave. Të njëjtat raporte theksojnë edhe faktin që progres ka në zbatimin e reformës në drejtësi. Këtë gjë e thekson edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, pasi pastrimi i parave është shumë i lidhur edhe me reformën në drejtësi.

Ndërkohë, nga gjetjet tona rezulton se jo i gjithë kuadri ligjor është i përshtatur me rregulloren dhe legjislacionin e BE-së në luftën kundër pastrimit të parave. Vlen të theksohet këtu direktiva e BE-së së vitit 2018, numër 1673 e Parlamentit dhe Këshillit të Europës, e cila ka të bëjë me luftën kundër pastrimit të parave nëpërmjet të drejtës penale, si dhe parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, e cila është një rregullore e ndërtuar pikërisht mbi bazën e kësaj directive. Theksi këtu vihet pikërisht te legjislacioni penal dhe rregullimi i legjislacionit penal, me qëllim arritjen e objektivit parandalues të ndëshkimit penal, ose më saktë frikësimin e atyre personave, të cilët dëshirojnë të ndërmarrin aktivitetin e jashtëligjshëm, ashtu sikurse është edhe pastrimi parave.

Ndërkohë, është edhe një rregullore tjetër e BE-së, e vitit 2019, që ka hyrë në fuqi në vitin 2020, e cila ka krijuar një kornizë për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte, që mund të paraqesin një kërcënim për sigurinë ose rendin publik në BE ose në shtetet e tij anëtare. Fjala këtu është për ato investime të huaja direkte, që mund të cenojnë pikërisht rendin dhe sigurinë në BE. Nuk e kemi ne në legjislacionin tonë një ligj të tillë. Kemi kërkuar, kemi pyetur dhe nuk na rezulton që vendi ynë të ketë një legjislacion, i cili mbrohet pikërisht nga këto investime të huaja keqdashëse, të cilat kërkojnë të futen në ekonominë tonë qoftë nëpërmjet parave të ligjshme, qoftë nëpërmjet parave të jashtëligjshme, me qëllim që të na cenojnë ekonominë, rendin dhe sigurinë.

Nirvana Deliu – Ndjesë, për të respektuar kohën, nëse mundeni në 2 minuta të mbyllësh fjalën.

Skerdian Kurti – Po.

Në lidhje me legjislacionin, kemi konventat e ratifikuara nga Shqipëria, ku do të veçoja: konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm, të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope, konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, konventën e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit, konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe financimit të terrorizmit.

Legjislacioni penal është i plotë edhe në këtë rast, kemi nenin numër 287 “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”; nenin 287/a “Çelja e llogarive anonime”; 287/b “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale, ose veprimtaria kriminale”, “Dënimi plotësues”; nenin 36 “Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale”; nenin 7 “Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj”, ku parashikohet se ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj, që jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kryen në dëm të interesave të shtetit ose të shtetasit shqiptar kriminele dhe pastrimit të produkteve të veprës penale, ose veprimtarisë kriminale; të mos harrojmë Kodin e Procedurës Penale, ligjin për SPAK-un dhe Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; reformën në drejtësi; ligjin nr. 10192, (i ashtuquajtur “Ligji antimafia”) “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimin dhe korrupsionin nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”; ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar; ligjin e vitit 2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, edhe ky i ndryshuar.

Ndërkohë, përveç masave me karakter të drejtpërdrejtë për parandalimin e pastrimit të parave, kemi edhe ligjet të tjera, të cilat kanë një ndikim të tërthortë në parandalimin e këtij fenomeni, ndër të cilat mund të përmendim: ligjin nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjin nr.112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar; ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”; ligjin nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për tregjet e kapitalit”; ligjin nr. 66/2020, datë 21.05.2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”; ligjin nr. 56/2020, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”; ligjin nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”; ligjin nr.157, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”; ligjin nr. 154/2020,

“Për regjistrin qendror të llogarive bankare”; ligjin nr. 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”

Të gjitha këto masa ligjore janë në përputhje edhe me rekomandimet e institucioneve të ndryshme, sidomos ndërkombëtare, në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave të pista.

Për më tej vazhdon kolegu Ledion Shahini.

Nirvana Deliu - Ju falënderoj, Skerdian!

Ledion, fjala për ju.

Ju lutem, keni parasysh kohën!

Ledion Shahini – Faleminderit, Nirvana!

I nderuar kryetar,

Të nderuar pjesëmarrës,

Pjesa tjetër ku është fokusuar analiza ka të bëjë me pjesën e karakterit institucional. Pra, ajo që ne kemi bërë më tej është që, përveç atyre që kanë dalë nga të gjitha raportet, por edhe konsultimi i dokumentacioneve të brendshme të institucioneve, pjesë e strategjive, planeve apo dhe dokumenteve që ekzistojnë në institucione, jemi përpjekur të krijojmë një pjesë të ndërlidhjes se ku duhet të bëhen ndërhyrjet institucionale. Në këtë aspekt unë do të përmend vetëm pak pika, që lidhen me raportet kryesore, pra te raporti vjetor i BE-së për Shqipërinë 2024, që ka pak ditë që ka dalë, përmendet fakti që kemi progres, por, nga ana tjetër, përmendet që teknikat e hetimit financiar, të ndjekura nga policia dhe prokurorët, kanë ende nevojë për përmirësim, nuk ka një qasje strategjike për identifikimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Gjithsesi, njëfarë progresi është bërë për sa i përket kapjes dhe konfiskimit të aseteve.

Një gjë tjetër, që theksohet, është edhe pjesa e historikut të të dhënave të personave për dënimet e pastrimit të parave, pra mbetet i paplotë aspekti i të dhënave në aspekt kohor.

Kemi raportin e Komisionit European mbi studimin e ligjit, i cili përsëri thekson diskordancën e madhe që ekziston midis sekuestrimit dhe konfiskimit, pra përsëri ka një ngërç sa i përket ndjekjes së procedurës. Në agjendën kombëtare të reformave 2024-2027, pra *growth plan*, janë dy pika, që përmendin fort aspektin institucional, pika 5.1.1, që synon krijimin e zyrës së rikuperimit të pasurive, dhe pika 5.1.2, përditësimin e platformave për mbledhjen e të dhënave sa i përket krimit të organizuar.

Në këtë kuadër, disa nga gjetjet kryesore që ne mendojmë se janë për t'u marrë në konsideratë, janë:

Së pari, krijimi ose fuqizimi i një njësie të unifikuar, e cila të bëjë analiza të thelluara të të dhënave, që lidhen me individin për të ardhura-shpenzimet. Themi krijim apo fuqizim, sepse ka struktura të tilla, por aktualisht sistemi i të dhënave që funksionon nuk është i plotë, pra nuk merr në konsideratë të gjithë burimin e të ardhurave, nga njëra anë, por, nga ana tjetër, nuk ndërlidhet më të gjitha sistemet e kryerjes së shpenzimeve të një individi për një periudhë të caktuar kohore, pra nuk ka një specifikim as në aspektin kohor të analizës, as në marrjen e të gjithë informacionit. Për momentin ka disa zhvillime të fundit, që lidhen me DIVA-n, ku i referohem këtu edhe ligjit të ri për të ardhurat, që futet në fuqi të vitin 2025, pra pjesa e dypunësimit, ulja e nivelit të personave që janë të detyruar të bëjnë deklarinë e të ardhurave vjetore, pra janë një sërë masash, por përsëri si sistem, pavarësisht se i shërben qëllimit specifik, kur vjen puna te pastrimi i parave, duhet të jetë më i plotë, pa i hyrë pastaj cili është institucioni që duhet ta ketë këtë përgjegjësi.

Tjetër, që duhet parë në këtë aspekt, është që krimi financiar, të shikohet apo hetimet paralele financiare të fillojnë të veprojnë edhe në aspektin e taksave dhe të tatimeve. Pra, të mos shikohen si të shkëputura, por të shikohen të korreluara me hetimet e tjera.

Një gjë shumë e rëndësishme lidhet edhe me pjesën e përdorimit të të dhënave ekonomike, të cilat normalisht sistemi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dhe një manual për përcaktimin e riskut kur vjen puna te bizneset, por mendojmë që mund të këtë hapësirë edhe për përmirësimin e indikatorëve për të përcaktuar ato njësi apo subjekte, që janë me risk për pastrim parash.

Gjithashtu, një problem që lind në pjesën e sistemit të të dhënave lidhet me faktin që janë disa aktivitete ekonomike, të cilat sot për sot në Shqipëri, duhet theksuar, janë në minimumin e tyre në mbledhjen e informacionit, sidomos kur vjen puna tek aktivitete, si: tregtia elektronike, tregu i monedhave virtuale, për të cilat ka shumë pak informacion të disponueshëm, por që janë nga mënyrat që po përdoren për pjesën e pastrimit të parave. Është e nevojshme, gjithashtu, edhe një plotësim i bazës ligjore në këtë kuadër për sa i përket aspektit të klasifikimit të evazionit fiskal, duke referuar referencën e evazionit. Pra, është e paqartë kjo pjesë kur një nivel i caktuar evazioni kalon për ndjekje dhe kur quhet shkelje administrative.

Gjithashtu, është e nevojshme që të përfshihen edhe në kategorinë e veprës penale ato që lidhen me taksat dhe tatimet.

Një aspekt tjetër institucional, ku gjykohet se është i nevojshëm për t'u përmirësuar apo për t'u parë në aspektin e pastrimit të parave, lidhet edhe me pjesën e doganave. Në aspektin teorik është një nga, le të themi, mënyrat më masive në pastrimin e parave, nëpërmjet faturimeve hyrje-

dalje, të cilat shpesh mund të jenë subjekt i pashoqëruar me lëvizje mallrash apo shërbimesh, por vetëm faturash, pra është një nga mënyrat teorike më të njohura në këtë aspekt. Kështu që, në këtë kuadër është e nevojshme që të shihet mënyra e kontrollit doganor, sidomos kur flasim për kompani që kanë lëvizje të mëdha import-eksport.

Një pikë tjetër shumë e rëndësishme në aspektin doganor ka të bëjë me lëvizjen e transportin e parave *cash*. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme që të unifikohet niveli i gjobave me vendet e tjera të BE-së. Sot vlen të theksohet që janë shumë të ulëta për rastin e Shqipërisë, gjë që e bën individin në njëfarë mënyre të pandjeshëm ndaj gjobës krahasuar me sasinë e parasë që transporton. Një gjë tjetër, që është e rëndësishme, është krijimi i të dhënave historike të individit, si shembull marrim shpesh konceptin e individëve që bëjnë lëvizje një herë në dy-tre ditë jashtë, edhe pse nuk kalojnë atë 10 mijë euro, që është niveli. Nëse bën shumatoren që kalon për një periudhë të caktuar kohore, nuk është çudi që të ketë një sasi të konsiderueshme për këtë qëllim.

Po ashtu edhe këtu është e nevojshme që të shikohet pak Kodi Penal kur vjen puna në aspektin e mosdeklarimit nga fshehja, pra duhet të ketë një trajtim ndryshe për një person, i cili e ka vlerën mbi 10 mijë dhe nuk e deklaron, apo e dikujt tjetër që e ka fshehur diku dhe do të kalojë në mënyrë të fshehur, pra duhet parë edhe kjo në aspektin ligjor.

Shumë e rëndësishme është që të ndërliiden sistemet, sidomos kur flasim për sistemet e doganave, të policisë dhe sistemet aeroportuale, pra që të ndërliidhet informacioni në kohë reale për individin që lëviz.

Një tjetër me interes në këtë aspekt ka të bëjë me zhvillimin e kapaciteteve profesionale në të gjitha strukturat, është shumë e nevojshme të përdoren teknika specifike të hetimit, që kërkojnë patjetër edhe njohuri specifike nga të gjitha strukturat dhe institucionet, dhe ajo që është përsëri me rëndësi është krijimi i sistemeve statistikore në këtë kuadër.

Vihet re që në përgjithësi institucionet operojnë me raste, pra në bazë kërkesash, por nuk ka një historik të informacionit, pra që të themi për 5 apo 10 vjet ne të kemi një qëndrueshmëri informacioni për ta pasur më të lehtë identifikimin e këtyre rasteve.

Tjetër gjë, që është vënë re nga analizat, është edhe pjesa që lidhet me regjistrin e kompanive dhe të pronarëve përfitues. Ne sot kemi një, le të themi, ligj për sa i përket deklarimit apo bërjes publike të pronarëve përfitues, por që shpesh konsiderohet një përqindje shumë e lartë, ne e kemi 25% sot, pra pjesë që të bëhet publike. Ndërkohë, nga format dhe aspekti teorik vihet re

që shumica e personave që tentojnë të bëjnë pastrim parash kanë tendencën që të shtrihen në shumë kompani me përqindje më të vogël sesa e lejon ligji, në mënyrë që të rrinë të fshehur në aspektin e deklarimit, pra flasim për bërjen e emrit publik. Mund të qëndrojnë me 10% apo 1%, ç'rëndësi ka, por nëse flasim për vlera të mëdha, patjetër që këto bëhen të rëndësishme.

Ajo që po vihet gjithmonë e më shumë re është fakti që pastrimi i parave përgjithësisht ka tendenca sektoriale, pra të fokusohet në sektorë specifike. Në këtë aspekt përsëri merr një rëndësi shumë të veçantë, që të bëhen analiza sektoriale të thelluara, dhe këtu, e ndërlidhur me atë çka thashë pak në fillim, mund të shihet edhe aspekti i përcaktimit të indikatorëve të riskut, specifik për disa sektorë. Pra, kemi një indikator risku, më së shumti e parë në aspektin e mbledhjes së të ardhurave, por ndoshta mund të jetë me vend që të shihet edhe përcaktimi apo implementimi i disa indikatorëve, të cilët më së shumti lidhen me qëllimin e pastrimit të parave.

Tjetër gjë, që është vënë re, është edhe aspekti i infrastrukturës fizike. Në institucione përgjithësisht ka mungesë të sistemeve të sofistikuara, sidomos kur vjen puna te sistemet që janë me përdorim masiv të dhënash, ose, siç njihen ndryshe, *big data use systems*, pra që të ketë mundësinë e ndërlidhjes së informacioneve të shumta për të përcaktuar raste, të cilat kanë risk për pastrim paraje.

Po ashtu me shumë rëndësi, që ndërlidhet edhe me atë çfarë tha dhe Skerdi më përpara, ka të bëjë me rritjen e bashkëpunimit, jo vetëm në aspektin e institucioneve brenda me institucionet jashtë, por është shumë e rëndësishme në këtë aspekt që të vihet re edhe ndërlidhja me shoqërinë civile, e cila në shumë raste mund të ketë profilizime shumë specifike, të cilat ndihmojnë në pastrimin e parave.

Kjo është pak a shumë përmbledhje e të gjithë atyre çka ne kemi bërë gjetje, që lidhen me komponentin 4 të shtyllës 2. Për më tej, në aspektin e diskutimeve të hapura, për të pasur një vëmendje më të thelluar dhe më të gjerë, ne kemi menduar disa pika, por që janë më se të hapura për diskutim, pra të gjitha ato çka ne thamë deri tani, por edhe ku duhet ta vendosim fokusin për diskutime të mëtejshme.

Ju faleminderit.

Nirvana Deliu – Të falënderoj, Ledion!

Faleminderit, Skerdian!

Besoj se me dy prezantimet u bë një pasqyrë e plotë se çfarë është lufta kundër korrupsionit dhe ku ndodhet Shqipëria si në kuadrin legjislativ, ashtu dhe në atë institucional.

Tashmë kam kënaqësinë që hapësirën e fjalës ta lë për ju. Mirëpresim çdo kontribut, çdo koment apo sugjerim që do të vijë nga ju! Thjesht një element që do të doja që ta kini parasysh, është elementi i kohës, në mënyrë që të jemi sa më koncizë dhe të respektojmë kohën e hapësirën për të gjithë.

Fjala për juve.

Saimir Boshnjaku – Përshëndetje!

Në radhë të parë, ju falënderoj për ftesën!

Unë jam drejtori i Policisë Kufitare dhe Migracionit, i mirëpres tezat për diskutim dhe do të doja, së pari, të prezantoja punën e departamentit të Policisë Kufitare, nëpër pikat e kalimit kufitar, siç edhe ju përmendët, që është një element shumë i rëndësishëm i kontrollit. Dua të them se ne, si Polici Kufitare, kemi pasur disa raste të kapjes së mosdeklarimit të të hollave në kufi dhe nga viti në vit kjo ka ardhur në rritje. Dua të përmend disa statistika. Për shembull, në vitin 2022 kemi pasur thuajse 32 raste me rreth 3,6 milionë euro dhe kjo kryesisht është bërë nga individë ose nga kompani transporti, të cilët transportonin para të padeklaruara nëpërmjet pikave të kalimit të kontrollit kufitar; për vitin 2023 kemi pasur 79 raste me rreth 2 milionë e 800 mijë euro; ndërsa për vitin 2024 kemi thuajse 62 raste me rreth 2,3 milionë euro. Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me prokuroritë e rretheve dhe një risi, të cilën do të doja ta theksoja këtu për auditorin, është edhe bashkëpunimi që kemi me partnerët ndërkombëtarë. Kemi një rritje shumë të madhe të bashkëpunimit me palën britanike, me palën italiane dhe me partnerët tanë, të cilët bashkëpunojnë me Policinë e Shtetit, lidhur me këtë fenomen. Një rast për t'u përmendur është edhe ai që ndodhi mbrëmë në pikën e kalimit kufitar të Murriqanit, në lidhje me transportin e parave *cash*, me rreth 600 mijë euro, por ky është një proces i vijueshëm.

Duke parë punën konkrete që bëhet apo duke parë vështirësitë që ne hasim, kemi vënë si synim kryesor rritjen e strukturave të Policisë së Shtetit, nëpërmjet trajnimeve, nëpërmjet detyrimeve që kemi, bazuar në analizën e riskut dhe pa penguar qytetarët e tjerë. Ky është një fenomen i cili kërkon edhe investime, me qëllim që pjesa përfituese nga strukturat shtetërore, në rast se do të rriten kapacitetet logjistike për strukturat e Policisë së Shtetit, do të jetë më përfituese dhe do të jetë një bazë shumë e mirë qoftë për prokurorinë apo për agjencitë e tjera, për të nisur investigimet dhe për të pasur rezultate konkrete.

Këto ishin disa detyrime të cilat strukturat e Policisë Kufitare janë të angazhuara t'i përbushin edhe në të ardhmen dhe besoj se do të kemi edhe rezultate konkrete.

Faleminderit!

Nirvana Deliu – Faleminderit, zoti Boshnjaku!

Zonja atje kishte një koment.

Dëshira Mena – Përshëndetje!

Faleminderit për ftesën!

Quhem Dëshira Mena dhe vij nga Unioni i Inxhinierëve Shqiptarë. Kam qenë edhe në disa tryeza të tjera të këtij niveli dhe jam shumë e lumtur që bëj prezent qëndrimin tonë si Unioni i Inxhinierëve Shqiptarë për këto tema kaq të rëndësishme, siç është lufta kundër korrupsionit, pastrimi i parave, sundimi i ligjit, që në fund të fundit janë shtyllat e ndërtimit të një jete ashtu siç duhet në një vend.

Ne, si Unioni i Inxhinierëve Shqiptarë, një pjesë të mirë të efekteve që jep korrupsioni apo moszbatimi i duhur i ligjeve, e ndiejmë çdo ditë në punën tonë të përditshme. Këtu marr shkas nga të dyja mënyrat që ne kemi konstatuar dhe vëmë re çdo ditë, të cilat e gërryejnë nga pak shoqërinë tonë, që janë korrupsioni i dukshëm dhe korrupsioni i padukshëm. Çfarë dua të them me korrupsion të dukshëm dhe me korrupsion të padukshëm?

Korrupsioni i padukshëm bëhet në nivele legislative, i cili ligjërohet dhe pastaj është shumë e vështirë t'i bëhet atij një skaner, një analizë për të kuptuar se ku janë kufijtë e zbatimit të atij ligji që tashmë është bërë pjesë e legjislacionit tonë. Këtu e kam fjalën për projektligjet për Urdhrin e Inxhinierit dhe Urdhrin e Inxhinierit Hidroteknik, të cilat unë i ngre gjithmonë për t'i marrë si shembull dhe për të ilustruar situatën, dy projektligje këto, por edhe ligje të tilla të ngjashme, të cilat krijojnë një skemë paralele për të menaxhuar fondet publike, ashtu siç aktualisht i menaxhon ministria. Në një vend të caktuar shteti është garantues i jetës dhe ne, si publik, besojmë vetëm te forca e ligjit dhe te forca e shtetit. Kështu që, të delegosh me ligj pushtet dhe t'ua japësh një grupi njerëzish, që ata më pas të krijojnë skema të tilla korruptive, të cilat do të jetë shumë e vështirë për t'i kontrolluar dhe monitoruar, nuk është hapi i parë për parandalimin e korrupsionit dhe të pastrimit të parave. Thjesht për ilustrim, projektligji që unë përmenda, në fakt, është një paralele e projektligjit nr. 8402, pra të gjitha kompetencat e ligjit nr. 8402, që menaxhon inxhinierinë dhe, në fakt, këtë e bën Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, kërkon t'i rrëmbejë

nëpërmjet një projektligji tjetër paralel. Këtë e mora si shembull, për të thënë që është shumë e vështirë të identifikohet korrupsioni i fshehur dhe është shumë e vështirë më pas të luftohet.

Korrupsioni i dukshëm dhe pastrimi i parave në aktivitetin tonë të përditshëm janë të gjitha ato skema të cilat parafolesit i përmendën dhe janë shumë të sakta, fshehja e aktivitetit, kryerja e shërbimeve dhe e punëve të pafiskalizuara, kur normalisht çdo proces pune duhet të jetë i fiskalizuar, duhet të ketë një faturë tatimore dhe në këtë mënyrë çdo gjë është e zbardhur. Ne e dimë shumë mirë që në punët inxhinierike shpeshherë ka mjaft punë të cilat nuk janë kaq të zbardhura dhe kaq të verifikueshme. Për ne ka rëndësi ngritja e këtij grupi pune, ku ne të ndihemi mirë dhe të përfaqësuar për të ngritur problemet tona, duke i bërë ato prezente dhe për të ndikuar sadopak në krijimin e një kuadri legjislativ të përshtatshëm dhe në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian.

Faleminderit për kohën!

Nirvana Deliu – Ju lutem, mund ta fikni pak mikrofonin?

Ju faleminderit!

Skerdian, Ledion, në momentin kur mendoni se mund të ndërhyni për të bërë komente, jeni të lirë.

Skerdian Kurti – Në lidhje me atë që tha zoti Boshnjaku për rastet e mosdeklarimit të parave në kufi, me të drejtë ai thotë se një nga masat që duhet marrë është rritja e strukturave të Policisë së Shtetit, pikërisht për të kontrolluar dhe për të rritur numrin e gjetjeve, të kapjeve të parave, të cilat kalojnë nëpërmjet kufirit, vetëm se duhet pasur parasysh që ndërmarrja e këtyre masave gjithmonë kërkon një buxhet më të madh, ndërkohë buxheti i vendit tonë është ai që është dhe ai buxhet duhet të ndahet ndërmjet sektorëve të ndryshëm. Në momentin kur ne kërkojmë rritje të strukturave policore apo të strukturave të tjera, të cilat marrin pjesë në luftën kundër kriminalitetit dhe, në rastin konkret, kundër pastrimit të parave, kjo duhet analizuar me saktësi. Nuk jam kundër, vetëm se duhen bërë matje të sakta, nëse vërtet duhet rritur struktura e Policisë apo duhen ndërmarrë masa të tjera, me qëllim që ato para të cilat buxheti i shtetit do t'i kalojë në rritjen e numrit të punonjësve të Policisë së Shtetit të jenë efikase dhe eficiente. Për shembull, drejtori tha se, nëse nuk gabojmë, në vitin 2024 janë 62 raste me një vlerë prej 3, 2 milionë eurosh. Nuk më duket se është e vogël kjo shifër e kapur. Problemi është se, nëse do të shtojmë numrin e punonjësve të Policisë së Shtetit, në këtë rast, a do të kemi rritje të numrit të gjetjeve? Nëse do të shtohen, i bie që ato para, të cilat mund të dedikohen në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, të

infrastrukturës së vendit e me radhë, të shkojnë në një sektor i cili ndoshta është eficient me këtë që ka dhe do të ketë një ngopje apo një destinacion të ndryshëm të këtyre parave.

Megjithatë, ky është një reflektim të cilin ne do të përpiqemi ta mbajmë në raport, por përpara se të themi që duhet marrë një masë e tillë, duhen bërë analiza akoma më të mëdha, sipas mendimit tim, pra nëse vërtet është e nevojshme rritja e numrit të forcave të punonjësve të Policisë, në lidhje me këtë pikë.

Ndërsa, sa i përket ndërhyrjes së zonjës Dëshira Mena nga Unioni i Inxhinierëve Shqiptarë, në lidhje me ligjet, me korrupsionin e padukshëm apo të dukshëm, jam dakord, edhe krijimi i ligjeve duhet studiuar mirë. Nëse është e vërtetë që një projektligj i tillë krijon skema korruptive, kjo është një kampanë alarmi për të gjithë hartuesit e këtij projektligji. Duhet parë me kujdes dhe, nëse kjo është e vërtetë, atëherë do të merren masat e duhura që edhe ky ligj të mos lehtësojë problemet e mëdha që ne kemi në lidhje me korrupsionin.

Nirvana Deliu – Po, zotëri.

Ervin Koçi – Shumë faleminderit, zonja Deliu!

Faleminderit për ftesën!

Unë jam Ervin Koçi, drejtues i Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

Fillimisht, unë falënderoj nismën dhe rolin proaktiv që ka marrë Kuvendi për sundimin e ligjit, pra tashmë jo vetëm harton ligje, por bën edhe një vlerësim real të monitorimit dhe të zbatimit të tyre dhe pas vlerësimit del me rekomandime konkrete se si të përmirësojmë efektivitetin e funksionimit të institucioneve, në këtë rast të sistemit parandalues të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, si dhe luftën kundër këtij fenomeni.

Unë falënderoj edhe ekspertët dhe të gjithë grupin e punës që ka hartuar një dokument, i cili shërben si bazë për përmirësim dhe për daljen me rezultate konkrete.

Shkurtimisht, unë do të ndalem në tri çështje.

E para, në prezantim nuk doli, por besoj se ishte në raport, është miratuar Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit nga Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i cili drejtohet nga Kryeministri, me përfshirjen e institucioneve të pavarura të sistemit të drejtësisë, të Bankës së Shqipërisë, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe institucioneve të tjera. Kjo strategji është shumë e rëndësishme dhe ka 50 masa në planin e saj të veprimit. Në datën 19, së bashku me të gjitha institucionet këtu, të cilat kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, ne kemi një takim

me partnerët ndërkombëtarë, me donatorët, për zbatimin e saj me efikasitet, sipas planit të veprimit dhe në kohë.

Unë do të falënderoja shumë edhe sektorin privat dhe më vjen shumë mirë që sektori privat dhe shoqëria civile janë pjesë, sepse edhe ne në Strategjinë Kombëtare kemi pasur përfshirjen e sektorit privat, disa prej të cilit janë edhe në këtë tavolinë. Kjo është në lidhje me strategjinë.

Njëkohësisht, edhe Vlerësimi Kombëtar i Riskut është një dokument tjetër strategjik. Edhe ai ka disa masa planveprimi, të cilat ne i monitorojmë çdo 4-mujor. Viti i parë i zbatimit të planit të veprimit është këtë vit. Unë jam i kënaqur që pjesa më e madhe tashmë, mbi 80% e masave të planit të veprimit për vitin 2024, janë realizuar, pavarësisht që në vitet e ardhshme 2025 dhe 2026 do të jetë më i ngarkuar dhe do të kërkojë më shumë angazhim nga të gjitha institucionet.

Besoj se këto dy dokumente strategjike janë shumë të rëndësishme dhe aty ndërtohet edhe i gjithë fokusi i punës për të ardhmen, kryesisht për rritjen e efikasitetit të koordinimit ndërinstitucional.

Për rritjen e bashkëpunimit, që është një pikë shumë e rëndësishme, sepse për të qenë të sigurtë pastrimi i parave nuk kërkon thjesht angazhimin e një institucioni, por kërkon angazhimin e të gjitha institucioneve, qysh nga ligjvënësi, tek institucionet ekzekutive, te sistemi i drejtësisë, por edhe te shoqëria civile dhe te publiku, njëkohësisht, Komiteti i Bashkërendimit, i drejtuar nga Kryeministri, që drejtohet nga Agjencia e Inteligjencës Financiare, së bashku me sektorin privat, kanë krijuar grupin teknik ndërinstitucional të punës. Janë të përfshira 25 institucione publike dhe 8 nga sektori privat, me të cilat ne mbledhemi të paktën 1 herë në 2 apo 3 muaj dhe diskutojmë për çështje mjaft të rëndësishme, sidomos për efikasitetin e koordinimit ndërinstitucional, duke krijuar disa nëngrupe. E rëndësishme është që në dhjetor, kur kemi mbledhjen e radhës, ne do të miratojmë dy dokumente të rëndësishme për vitin 2025. Dokumenti i parë është programi i integruar i rritjes së kapaciteteve institucionale kundër pastrimit të parave, përgjithësisht i orientuar tek trajnimet. Pra, të gjitha institucionet paraqesin kërkesat e tyre, ne arrijmë t'i përpunojmë dhe, pasi ua paraqesim donatorëve, partnerëve, por edhe vetë, në mënyrë që të kemi trajnime në këtë fushë, për rritjen e kapaciteteve, që ishte edhe shqetësimi juaj, sidomos në fushën e hetimeve financiare.

Së dyti, do të miratojmë edhe Strategjinë për Ndërgjegjësimin e Publikut. Është mjaft e rëndësishme që ndërgjegjësimi i publikut për pastrimin e parave të rritet, siç është edhe edukimi financiar. Për të qenë të sigurtë, jemi vendi i fundit në Europë sa i përket edukimit financiar. Edhe në këtë fushë ne nuk kemi ndonjë kulturë. Takimi me studentët, me Komitetin e Biznesit, me

punonjësit e institucioneve publike apo private, duhet të kthehet në fokusin e punës sonë. Ne e miratojmë atë në dhjetor dhe në janar fillojmë me zbatimin. Jemi duke folur edhe me donatorët, në mënyrë që edhe ata të ndihmojnë për ta zbatuar atë me sukses dhe duke bërë një sondazh në fillim, për të parë se ku jemi.

Ndërsa për çështjen e tretë, që unë besoj se është e rëndësishme, ne jemi të gatshëm, si institucion, dhe të gjithë ekspertët që kemi, por, nëse dëshironi, mund të gjejmë edhe ekspertë ndërkombëtarë, sepse e kemi këtë mundësi, për të bashkëpunuar dhe për të dhënë çdo lloj kontributi që ju mendoni se është i vlefshëm për rritjen e efikasitetit në luftën kundër pastrimit të parave. Ne presim edhe vizitën e MONEYVAL-it në fillim të vitit 2026 për vlerësimin e Shqipërisë, përsëri, në lidhje me efektivitetin e sistemit. Tashmë janë duke punuar të gjitha institucionet, të cilat gjej mundësinë për t'i falënderuar për kontributin e jashtëzakonshëm që kanë dhënë, së bashku me sektorin privat, në mënyrë që të përgatitemi për të dalë me sukses nga ky vlerësim, pasi është edhe metodologjia e re që FATF-ja ka përgatitur për vlerësimin e vendeve, që nis këtë vit me Belgjikën dhe me Lituaninë. Duke ju falënderuar, ne jemi të gatshëm për çdo lloj angazhimi konkret dhe për të vazhduar më tej me përmirësimin e dokumentit.

Shumë faleminderit!

Nirvana Deliu – Faleminderit, zoti Koçi, për të gjithë pamjen e përgjithshme, për masat që keni marrë, por edhe për planet e së ardhmes në institucionin tuaj!

Po, zoti Besfort.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Atëherë, zoti Ndoi.

Gentian Ndoi – Përshëndetje!

Jam Gentian Ndoi, drejtor i strukturës për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar. Realisht, mbështes pjesën dërrmuese të atyre që tha drejtori i AIF-së, pasi aktualisht policia dhe strukturat e tjera po mundohen të kenë një qasje proaktive ndaj kësaj vepre penale. Për veprën penale të pastrimit të parave, kryesisht aktet ligjore që trajtojnë pasuritë që rrjedhin nga veprimtaritë kriminale, në perceptimin tim janë goxha të mira. Ne kemi një Kod të Procedurës Penale i cili e trajton veprën e pastrimit të parave, kemi një ligj, të cilin në zhargonin e përditshëm e quajmë “ligji antimafia”, i cili merret administrativisht me pasuritë që rrjedhin nga krimi dhe, përgjithësisht, eksperiencia e policisë dhe e organeve ligjzbatuese është goxha e mirë në trajtimin e tyre. Megjithatë, vepra e pastrimit të parave paraqet shumë specifika në trajtimin dhe në hetimin

e saj, pasi duhet të dokumentosh në mënyrë shteruese që këto pasuri kanë rrjedhur nga një veprimtari specifike e krimit. Përgjithësisht, prokuroritë kërkojnë atë të cilën ne e quajmë “vepra mëmë”, e cila në disa raste është e vështirë të identifikohet si duhet. Pastaj prokuroritë kanë edhe vështirësitë e tyre në hetimin e saj dhe këto janë vepra të cilat një prokuror nuk i heton me qejf të madh. Ka pasur një dinamikë të tillë gjatë viteve, ku referimet për veprën e pastrimit të parave përgjithësisht kanë qenë në një numër shumë të madh dhe efektiviteti i hetimit nuk ka pasur rezultatin e duhur. Çfarë dua të them me qasjen tonë proaktive, të cilën e kemi në punën tonë të përditshme?

Nën udhëheqjen e AIF-së kemi nisur një lloj trajtimi tjetër të kësaj dinamike. Kjo do të thotë se ato që referojmë duhet të jenë referime të mira dhe duhet të bëjmë maksimumin që këto referime të përfundojnë atje ku duhet. Pra, subjektet ndaj të cilave ne nisim hetim duhet të ndëshkohen dhe pasuritë të sekuestrohen. Lidhur me këtë, siç tha edhe drejtori, kemi nisur takime, të cilat nuk janë takime burokratike, ku ne duhet të paraqitemi, por aty ne diskutojmë se çfarë vështirësish kemi. Bashkërisht, ne gjejmë mënyra që këto vështirësi t’i adresojmë atje ku duhet dhe të zgjidhen. Nuk kishte ndodhur, por aktualisht po ndodh dhe javës tjetër kemi një takim ku ne, i gjithë grupi i aktorëve, do të nisim një *tour* në të gjitha prokuroritë e qarqeve, me qëllim që të diskutojmë me prokurorët respektivë. Ne jemi aktorët që merremi me këtë punë, AIF-ja bën një punë të caktuar, struktura tjetër bën një punë tjetër, po ashtu edhe doganat dhe tatimet. Çfarë duhet të bëjmë që këto çështje të ecin? Ato që kanë brumë duhet të shkojnë në destinacionin e tyre dhe shohim që perceptimi dhe mënyra se si po funksionon kanë rezultate.

Lidhur me asetet kriminale, me asetet e rrjedhura nga krimi, jam krenar të them se kemi goxha eksperiencë të mirë. Rendimenti i sekuestimeve dhe i konfiskimit të këtyre aseteve është mjaft i madh, madje tani kemi kaluar në hallin, që kanë pasur shumë shtete europiane, se çfarë do të bëjmë me pasuritë e konfiskuara. Policia e Shtetit ka një qasje shumë të mirë, me ndryshimet strukturore, hetimi i pasurive të rrjedhura nga krimi ka qenë ekskluzivitet vetëm i Drejtorisë për Hetimin e Krimit Ekonomik, aktualisht është decentralizuar. Pra, hetimin për asetet e rrjedhura nga krimi e ka çdo strukturë që ndjek veprën mëmë. Për shembull, nëse niset një procedim për narkotikët, janë të detyruar t’u hetojnë pasurinë subjekteve të tyre. Kjo do të bëjë që rendimenti i procedimeve të nisura për hetim pasuror do të jetë shumë i madh.

Sigurisht, ka nevojë për trajnim, ka nevojë për ekspertizë, pasi me hetim pasuror do të merren struktura të cilat historikisht nuk janë marrë me këtë gjë. Për këtë arsye po hartojmë edhe

një plan trajnimi me ekspertët tanë më të mirë, që t'i asistojnë ato. Kështu, ne do të bëjmë atë që thuhet se çdo strukturë ligjzbatuese ndërkombëtare kërkon, pra që hetimi pasuror të jetë paralel me hetimin penal. Rendimenti është tmerrësisht më i lartë, krahasuar me një "hetim pasuror të ftohtë", siç ne e quajmë, ku, pasi ka ndodhur hetimi, është dënuar subjekti dhe pastaj merren me pasurinë e tij.

Jemi duke krijuar një qasje të re lidhur edhe me kriptovalutat. Informacionet janë që kriptovalutat përdoren gjerësisht, së pari, për të fshehur pasuritë e rrjedhura nga krimi, së dyti, për të lehtësuar mundësinë që këto pasuri të pastrohen. Kjo është një qasje e re për ne. Është një vështirësi të cilën e kemi jo vetëm ne, si një shtet i vogël, por, nga kontaktet me të gjithë partnerët e shteteve të Europës, ky është një problem që e kanë edhe ata. Po ecim me trajnimet dhe, mbi të gjitha, po ecim me një bazë ligjore për trajtimin e rasteve dhe ne konstatojmë që kemi raste të kriptovalutave. Vështirësi ka dhe ne po luftojmë jashtëzakonisht, me mbështetjen e ministrisë, që të arrijmë të kemi një qasje sa më të madhe në *database*-at shtetërore dhe private, nëse mundemi. Është shumë e nevojshme, pasi bëhet një punë burokratike, duke bërë shkresa pafund, duke ua çuar institucioneve, ata na përgjigjen dhe në shumë raste bllokojmë edhe punën tonë, edhe punën e tyre, ndërkohë një oficer nga zyra e tij mund ta bëjë këtë qetësisht, qartësisht, pa rënë në sy dhe në fund fare të ketë një produkt, të cilin t'ia referojë prokurorit dhe më pas prokurori t'ia çojë gjykatës. Kështu rritet ky aktivitet jashtë mase, duke mos bllokuar edhe punën e shumë institucioneve. Po punojmë, jemi në rrugë të mbarë dhe kemi pasur disa arritje.

Risi në strukturën tonë të re të policisë, gjë shumë e mirë kjo, është që për herë të parë ne kemi analizë financiare të mirëfilltë, për të cilën kemi rekrutuar nga strukturat private. Pra, kështu policia ka mundësi të bëjë diçka efektive dhe cilësore.

Nirvana Deliu – Faleminderit, zoti Ndoi!

Zoti Llamallari, fjala është për ju. Më pas fjalën do ta marrë zoti Karameta.

Besfort Lamallari – Në fakt, ju përgëzoj për punën që keni bërë!

I kam lexuar me shumë kujdes raportet, kam dërguar edhe komente më herët, të cilat më shumë janë plotësime dhe përditësime të informacionit, përfshirë edhe referencat në raportin më të fundit të vitit 2024, por edhe zhvillime që kanë ndodhur në kuptimin institucional.

Nëse këtu i referohemi Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, në fakt, edhe pse draftligji për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve është në proces, shumë shpejt do të miratohet, pra është në fazën e bashkërendimit final. Shumë shpejt do të kalojë në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, për t'iu

nënshtuar më pas edhe procedurave parlamentare të shqyrtimit këtu, në Parlament, dhe miratimit të tij, sipas afateve të parashikuara dhe të dakordësuara, i marrë si angazhim nga qeveria shqiptare, në raport me Komisionin European, qoftë kjo në “Udhërrëfyesin e shtetit të së drejtës”, qoftë në “Pozicionin negociues”, të cilin ne tashmë e kemi si udhëheqësin tonë në të gjithë rrugëtimin, të paktën, për grupkapitujt fillestarë. Këtu flas edhe si negociator për kapitullin XXIV.

Paralelisht kemi ecur edhe me strukturën. Siç e përmendi edhe drejtori, kemi një strukturë të posaçme për analizën financiare, e cila, sipas organizimit më të fundit që është bërë vitin e shkuar, përfshin analizën financiare dhe Zyrën e Rikuperimit të Aseteve. Kjo ka qenë një punë kolosale e bërë në mënyrë ndërinstitutionale, e udhëhequr nga Ministria e Brendshme, ku kemi pasur edhe përfaqësues nga institucionet e pavarura, si Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme, ekspertë nga pastrimi i parave gjithashtu, ku kemi mbështetjen e vazhdueshme të organizmave ndërkombëtarë, si Këshilli i Europës. Është shumë e rëndësishme për vetë faktin që ka edhe dy mekanizmat kyçë për matjen dhe vlerësimin e progresit të bërë në një vend, si përmes MANYVAL-it, ICRG-së, FATF-së, ashtu edhe grupit Egmont apo GRECO-s për korrupsionin. Pra, janë ekspertë të cilët na kanë asistuar në hartimin e këtij ligji shumë të rëndësishëm. Kemi parë edhe modelet më të mira europiane dhe këtu do të veçoja modelin francez. Për më tepër, ata janë angazhuar për të na mbështetur, duke qenë si mentorë të kësaj zyre të re, e cila do të bashkëpunojë në kohë reale me zyrat homologe të vendeve anëtare të Bashkimit European. E theksova këtë si zhvillimin më të fundit, për ta ndarë me ju dhe me publikun, por edhe për faktin që kjo platformë, pa dyshim, ka pozicionin për t’u shërbyer dhe për t’i ndihmuar institucionet në procesin e prezantimit të nismave ligjore. Për këtë arsye, së shpejti do të takohemi edhe në Kuvend, ku kjo nismë do t’i nënshtrohet diskursit politik dhe shqyrtimit parlamentar. Unë besoj fort se do t’i shërbejë shumë edhe nxitjes së rasteve të reja në luftën kundër pastrimit të parave. Pra, ky është një element i ri.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm, krahas atyre që janë të vazhdueshme, që dalin si detyrime në kuadër të integritetit të çdo vendi në Bashkimin European, si harmonizimi i kuadrit ligjor me rregulloret më të fundit, pra edhe nëse i referohemi projektligjit që unë sapa përmenda, i cili ndoshta duhet të ishte miratuar më herët, por për shkak se Rregullorja e BE-së doli tani, në vitin 2024, ne e stopuam procesin dhe i reflektuam edhe ndryshimet e bëra në Rregullore, do të thosha se është projektligji që do të miratohet, i cili është realisht më i fundit në kuptimin e përafrimit me direktivat, me *acquis*-në e BE-së.

Ka shumë akte, të cilat ju i përmendët edhe këtu, që janë pjesë e punës së përditshme për çdo institucion, i cili angazhohet për harmonizimin e kuadrit ligjor, ashtu siç ka edhe objektiva të tjera që janë pjesë e punës normale, rutinë, të bërë nga të gjitha institucionet bashkërisht, si konfiskimi i zgjeruar apo hetimet paralele financiare. Sigurisht, ka një trend pozitiv vitet e fundit ku shihet që të gjitha institucionet, jo vetëm Policia e Shtetit, kanë dëshmuar një rritje të çeljes së hetimeve financiare, por ajo që ne po synojmë të bëjmë pikërisht në këtë prizëm është që, krahas rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar, që ju me të drejtë e keni theksuar si një element kyç për këtë luftë, është edhe rritja e konsiderueshme e bashkëpunimit me Europol-in, përmes bashkëpunimit që ka Policia e Shtetit dhe jo vetëm, por tashmë edhe institucione të tjera qoftë përmes oficerëve të kontaktit, qoftë përmes kanalit SIENA. Këtu i kemi mëshuar fort këtij kanali të inkriptuar që përdoret nga *Europol*-i, me agjencitë ligjzbatuese të vendeve të ndryshme, përfshirë edhe Shqipërinë, që të shtojmë edhe institucione të tjera, krahas Policisë së Shtetit. Më e fundit, e njohur edhe nga progresraporti i vitit 2024, është Agjencia e Inteligjencës Financiare, janë edhe shumë institucione të tjera të cilat janë tashmë pjesë e këtij rrjeti, falë punës që ne kemi bërë në Ministrinë e Brendshme, ku Tatimet, Doganat, janë po aq të rëndësishme dhe përdoruese të këtij rrjeti.

Bashkëpunimin me Europol-in e theksova për faktin që një tjetër institucion po kaq i rëndësishëm që duhet evidentuar është edhe Eurojust-i, që nënkupton një fazë të fundit nga informacioni i agjencive ligjzbatuese në informacionin që merr vlerën e evidencës, në kuptimin e hallkave prokurori-gjykata. Në një takim të fundit të grupit negociator, me përfaqësues edhe prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, në selinë e Eurojust-it në Hagë, ne kemi kërkuar të kemi intensifikim të këtij bashkëpunimi dhe, konkretisht, duke u bazuar në bashkëpunimin shumë të mirë që ka Eurojust-i me Prokurorinë e Posaçme, ta zgjerojmë këtë edhe me prokuroritë e rretheve, që të vijnë në të njëjtën linjë me atë që përmendi edhe drejtori, pra për të pasur raste të shtuara edhe nga prokuroritë e rretheve. Ka disa prokurori të cilat, në fakt, kanë rritur rezultatet e tyre në këtë drejtim, por është shumë e nevojshme që kjo të jetë e unifikuar në shkallë kombëtare. Gjithashtu, në këtë aspekt kemi pasur një bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm, si dhe mbështetje nga Prokuroria e Përgjithshme.

Një tjetër element i rëndësishëm janë sfidat e fundit, të cilat i paraqiten jo vetëm Shqipërisë në vetvete, por edhe të gjitha vendeve të tjera, që lidhen me trendin e fundit, pra me mënyrën se si përdoren paratë e përfituara nga aktivitetet kriminale, përmes kriptovalutës apo formave të tjera,

duke vështirësuar punën e agjencive ligjzbatuese për gjetjen e tyre. Kjo është një çështje tjetër që ne po e ndjekim në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë. Konkretisht, shumë shpejt do të nënshkruajmë një marrëveshje me partnerët britanikë, ku, ndër të tjera, do të fokusohemi edhe në rritjen e kapaciteteve për analizën financiare dhe përdorimin e mjeteve më të sofistikuara, për t'u përfshirë dhe për t'u futur më thellë në *dark web* dhe në kriptovalutë.

Një tjetër element shumë i rëndësishëm, të cilin ju e keni përfshirë këtu, është konfiskimi i pasurive kriminale. Megjithatë, dua të them se ne duhet të guxojmë të shkojmë përtej asaj që Shqipëria tashmë ka treguar progres, që është përdorimi për qëllim social. Gjithashtu, kemi disa pasuri, të cilat i janë marrë krimit të organizuar dhe u janë dhënë komuniteteve të caktuara, qoftë grupeve të grave, subjekte të dhunës në familje apo viktimave të trafikimit apo edhe të rinjve, të cilët tashmë merren me punë të dobishme, që janë sipërmarrës të rinj, për t'i përdorur këto ambiente.

Megjithatë, ajo që konstatoj edhe nga përvoja disavjeçare tashmë në Ministrinë e Brendshme, është se ne vërtet duhet ta hapim diskutimin dhe duhet të diskutojmë për t'i dhënë një karakter më motivues hetimit në Shqipëri, me gjithë sfidat që paraqet dhe diskursin më se normal, që duhet të ndodhë, për rreziqet që mund të kishte përdorimi i një sasive të këtyre të këtyre të ardhurave në dobi dhe në vlerësim të kapaciteteve të burimeve njerëzore të angazhuara për hetimin dhe suksesin e arritur me këto hetime. Që do të thotë se ne sot nuk mund të kemi një oficer hetimi, pra një oficer të Policisë Kriminale, i cili të paguhet, me gjithë respektin, njësoj me dikë tjetër, që bën një punë ndoshta jo kaq të ngarkuar apo që duhet të jetë disponibël në çdo orar dhe në fund, falë punës së tij dhe nën koordinimin e prokurorisë, qoftë Prokurorisë së Posaçme apo prokurorit të rrethit, të arrijë në sekuestrimin një resorti turistik apo të një pasurie miliona euro. Pra, duhet të ketë një incentivim. Unë gjithmonë e kam mbështetur këtë, por, sigurisht, kjo kërkon një debat më të gjerë dhe më të shëndoshë. Domethënë, të angazhohen të gjithë se si mund të ishte kjo formulë që vërtet të kemi një vlerësim për punën e bërë, së pari, por edhe një motivim për të kuptuar që, sigurisht, kur ti punon për këtë, nuk mund të jetë njësoj. Realisht, kjo është diçka tjetër që është tentuar herë pas here, por nuk ka ndodhur.

Me këtë dua ta mbyll, por, duke shfrytëzuar këtë mundësi, për vetë diskursin publik që nxit kjo platformë, për vetë ndërveprimin më të ngushtë me Kuvendin, por, mbi të gjitha, për vetë integrimin europian, kjo edhe nga përvoja ime si negociator. Unë e kuptoj që vetë procesi integritetit, nuk është thjesht sa i kryen detyrat qeveria shqiptare apo institucionet shqiptare, por

është një proces transformues i shoqërisë shqiptare. Nëse ne flasim për luftën kundër korrupsionit dhe nëse flasim për luftën kundër pastrimit të parave, nuk mund të arrihet asgjë, nëse thjesht pritshmëritë janë tek institucionet dhe jo shoqëria të distancohet nga fenomene të tilla. Me këtë e mbyll, duke ju falënderuar për punën e jashtëzakonshme që keni bërë.

Nirvana Deliu – Shumë faleminderit, zoti Lamallari!

Në fakt, e quaj me shumë vlerë që sot kemi prezentë dy negociatorë të dy kapitujve kryesorë, që janë kapitujt XXIII dhe XXIV.

Fjalën e kanë zoti Karameta, më pas zoti Deralla dhe zoti Shiqerukaj.

Faleminderit!

Klajd Karameta – Faleminderit!

Ju përgëzoj për raportin shumë kompleks, i cili kishte prekur pjesën më të madhe të tematikave për të cilat po flasim.

Të jem i singhtë, shumica e gjërave u theksuan nga folësit, kështu që do të shkurtoj disa pjesë kryesore të fjalës sime, duke u fokusuar te dy-tri tematika që lidhen drejtpërdrejt me punën e Ministrisë së Drejtësisë.

Për sa i përket parandalimit të pastrimit të parave, ne si Ministri e Drejtësisë jemi të përfshirë kryesisht në dy drejtime: në hartimin e legjislacionit për të parandaluar këto fenomene dhe në monitorimin e profesioneve të lira, si noterët, për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme dhe për përmbaruesit privatë, të cilët shpesh në aktivitetin e tyre përfshihen në transaksionet treshë, duke u bërë ndërmjetës të kalimit të parave nga personi A te personi B dhe, së fundi, jemi aktivë në realizimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar për rastet kur organet hetimore kanë nisur punën e tyre të hetimit dhe, në kuadër të letrave të porosisë, ne bëhemi aktivë, duke dhënë asistencën tonë për organet e hetimit në punën e tyre në këtë aspekt.

Dua të ndalem në dy pika, të cilat kanë njëfarë interesi, pasi shumica e temave u folën më parë.

Realisht u fol për nevojën e ndryshimit të legjislacionit penal, që e gjej me shumë vend. Harmonizimi me direktivat duhet të jetë patjetër një nga ato pikat e rëndësishme, ku duhet të përqendrohemi për të parë legjislacionin penal, sidomos te Kodi Penal. Nëse më lejoni, jo si kritikë, por si sugjerim, në shumë tryeza, sidomos për ndryshimet në Kodin Penal, dalin propozime për një rregullim shumë të detajuar të Kodit Penal. Madje, kemi arritur deri aty sa... Po marr fjalën e kolegut jo si shembull të keq, por si për të ilustruar grupin e problematikave, të cilat dalin shpesh.

Për shembull, do të dalë një njeri me një shumë të caktuar lekësh atje dhe themi ta rregullojmë në Kodin Penal. Pa dyshim, Kodi Penal është një nga vendet, ku shkenca e së drejtës penale gjen atë, si të thuash, aktin më të rëndësishëm ligjor të shkencës penale, por duhet të vëmë në dukje që Kodi duhet të përmbajë formulimet e përgjithshme, ndërkohë që është detyrë shumë e rëndësishme e gjyqësorit, por edhe e organeve të prokurorisë që të tregojnë “talentin e tyre” si juristë, duke marrë veprat penale në fjalë dhe duke u bërë interpretim. Pra, kemi nevojë të jashtëzakonisht të madhe për interpretim. Edhe në vendet e Bashkimit Europian, përveç akademisë dhe përveç akteve ligjore, ne kemi jurisprudencën, pra vendimet e gjykatave, sepse shpesh kërkohet nga legjislatori që të hyjë në një rregullim shumë të detajuar. Më vjen keq ta them kështu, por nuk është detyrë e Parlamentit që të futë në kod çdolloj sjellje, se do të krijojmë volume pafund, ndërkohë që është detyrë kryesore e gjyqësorit t’i elaburojë nenet, të cilat janë në Kodin Penal, dhe të dalë me vendime, por janë detyrat e kolegjeve të bashkuara ose edhe e kolegjeve penale të Gjykatës së Lartë që të japin vendime udhërrëfyese për problematika të ndryshme që, për mendimin tim, janë të rregulluara në Kod.

Së dyti, u fol për aksesin te regjistrat.

Shumë organe shtetërore kanë regjistrat e tyre, të cilat i menaxhojnë dhe i mirëmbajnë. Më falni që po e them, por jemi të “bombarduar” nga kërkesat pafundme për akses në regjistra. Po, është shumë e drejtë për disa aspekte, por duhet të kemi edhe kujdes. Domethënë, duhet të peshojmë dy lloj interesash, pra interesin e organeve shtetërore për të kryer punët e tyre, nga ana tjetër, duhet të kemi kujdes të kufizojmë edhe abuzimin. Domethënë, ka arsye pse aksesin në regjistra për disa organe është i kufizuar dhe për disa të tjerë nuk është i kufizuar. Prandaj, duhet të kemi këtë gjë parasysh: këto rregulla, që janë bërë për një kufizim, kanë pikërisht në bazë mbajtjen parasysh të interesit të gjerë dhe shmangien e abuzimit, sepse në vendin tonë ka ndodhur shpesh me regjistrat, dhe këtë duhet ta themi. Unë nuk jam kundër asaj që të ketë akses nga organe të ndryshme, por duhet të bëhet më shumë kujdes, jo të hapet akses pa fund dhe pa anë, sepse përfundojmë në abuzim.

Së fundi, dua të flas për një tematikë që doli nga disa folës këtu në lidhje me pastrimin e parave. Për shembull, për sa u përket tregjeve të monedhave virtuale, kriptomonedhave, është e saktë që përdoren shpesh edhe për pastrimin e parave. Duhet të kemi parasysh që pastrimi i parave është një dukuri, e cila ndodh kryesisht me paranë, jo me kriptomonedhat. Pra, kur pastrohen paratë, pastrohen nëpërmjet parave.

Së dyti, kriptomonedhat përfaqësojnë një revolucion të madh për sa i përket anës teknologjike dhe, në perceptimin tim, në Shqipëri shikohen vetëm anët e këqija. Paratë pastrohen me para dhe ne nuk i kufizojmë paratë. Pa dyshim, kriptomonedhat mund të përdoren për të fshehur të ardhura, por duhet të kemi parasysh që tregjet financiare ndërkombëtare, për shembull, Shtetet e Bashkuara këtë vit Komiteti i Sigurimeve (CAC) ka licencuar për herë të parë *exchange traded fund*, të cilat kanë legjitimuar përfundimisht në Shtetet e Bashkuara në juridiksion përdorimin e kriptomonedhave. Me këtë dua të them se duhet ta përqafojmë teknologjinë, sepse nuk i shpëtojmë dot, nuk do të ikë, sepse ajo do të jetë këtu, do të vazhdojë dhe duhet që të kuptojmë më gjerë, së pari, që janë tema të ndërlikuara, por ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme zhvillimi. Në vendet, të cilat janë në avangardë, flasim për Shtetet e Bashkuara, Presidenti i zgjedhur ka bërë deklaratat se do t'i mbështesë dhe do t'i futë në legjislacionin e tyre, në mënyrë që të kenë zhvillim. Pra, duhet të kemi parasysh që të kemi kujdesin e duhur, por edhe të shikojmë anën e zhvillimit që ato mund të sjellin.

Pak a shumë, këto ishin disa nga pikat që kisha.

Edhe një herë, ju përgëzoj për raportin!

Faleminderit!

Nirvana Deliu – Faleminderit!

Tani fjalën e ka zotit Denis Deralla nga Banka e Shqipërisë.

Ju lutem, para se të filloni, duke qenë se jemi edhe në minutat e fundit, do të doja që folësit të kenë pak respekt për kohën.

Faleminderit!

Denis Deralla – Faleminderit!

Unë jam Denis Deralla, drejtor i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë.

Së pari, ju falënderoj për ftesën dhe për iniciativën në tërësi! Dua të jem shumë konkret në atë që do të them.

Nga prezantimet dhe diskutimet e parafolësve u pa qartë që kuadri ligjor dhe rregullativ në Shqipëri është harmonizuar dhe është linjëzuar me të gjitha direktivat dhe rregullat europiane. Praktikisht, edhe nga progresraporti u pa qartë që kanë mbetur detaje në përafrimin e plotë të kuadrit rregullativ me atë të BE-së.

Megjithatë, për sa i përket eficiencës së zbatimit të këtyre ligjeve dhe rregullave, sigurisht ka ende shumë për të bërë. Gjithsesi, ajo që dua të them, është se janë bërë shumë, ashtu siç e thanë

edhe drejtori i Agjencisë dhe drejtori i Policisë Financiare, është rritur mjaft efienca e këtyre strukturave dhe është fakt se para dy vjetësh dolëm nga lista gri, sepse u verifikua dhe u vlerësua që Shqipëria ka bërë hapa para në rritjen e eficiencës së punës së strukturave të parandalimit të pastrimit të parasë.

Problemi madhor që unë shikoj në pastrimin e parasë, dhe këtu dua të jem pak antirrymë, është se sot në Shqipëri, ndoshta nuk është më fare e nevojshme të pastrosh para, sot në Shqipëri ti mund të blesh gjithçka, nga apartamente, makina, deri tek investime të ndryshme në kesh, nuk ke nevojë fare të kalosh para përmes sistemit bankar apo të deklarosh burimin e të ardhurave të tua. Sot në Shqipëri janë vetëm tri struktura që të kërkojnë burimin e të ardhurave: është ILDKPKI-ja për zyrtarët; janë bankat, të cilat e kanë forcuar dhe e kanë zgjeruar kërkesën e tyre për fondet dhe për burimin e të ardhurave në maksimumin e tyre, dhe SPAK-u së bashku me Prokurorinë. Struktura të tjera, të cilat të kërkojnë burimin e të ardhurave, praktikisht nuk ka. Nëse u shpëton këtyre tri “rrjetave”, praktikisht lundron i qetë me çfarëdolloj shume parash që të kesh dhe me çfarëdolloj burimi që ta kesh krijuar këtë para.

Banka e Shqipërisë prej vitesh, tashmë që nga viti 2020, me Strategjinë Kombëtare të Parasë për Pagesat e Vogla, me ligjin për shërbimin e pagesave dhe me ligjin për llogaritë bazike vazhdimisht është munduar që ta reduktojë sasinë e parasë kesh në Shqipëri, sepse është sasia e keshit dhe lejimi i transaksioneve në kesh që bëjnë të mundur sot qarkullimin e parasë së pistë në Shqipëri.

Edhe shteti, përfshirë Ministrinë e Financave dhe ministritë e tjera përgjegjëse, pra të fokusuara në parandalimin e pastrimit të parasë, duhet të kenë fokus pikërisht format për parandalimin e transaksioneve në kesh. Ju në prezantimin tuaj i jeni referuar disi qoftë deklarimit të të ardhurave, sepse, në qoftë se ne do të kishim një deklaram personal të të ardhurave, do të krijonim një mundësi për kontrollin e të ardhurave të të gjithë individëve apo kompanive, do të kishim më tepër struktura kontrolluese në këtë formë. Sigurisht, nuk është e thjeshtë; nuk është diçka që bëhet sot për nesër, por, sigurisht, masat që duhet të ndërmerren nga strukturat shtetërore, duhet të jenë të orientuara drejt këtij drejtimi. Reduktimi i transaksioneve në kesh dhe kërkimi i llogarisë për burimin e fondeve, do të ndihmonte në uljen e pastrimit të parave.

Së fundi, për sa u përket monedhave krypto, nuk duhet të bëjmë gabimin që të ngatërrojmë këmbimin e formës së monedhës me pastrimin e parave. Qoftë zyrtarë e këmbimit valutor, qoftë kriptomonedhat, thjesht këmbajnë formën e monedhës, nga lekë mund ta kthejnë në euro, nga euro

në lekë apo nga lekë në *bitcoin*, por kjo nuk do të thotë që paraja u pastrua. Sigurisht, kjo lehtëson transfertën, lehtëson transferimin e parasë, por paraja në gjendjen e saj kesh mbetet në të njëjtat volume. Pra, paraja e pistë mbetet para e pistë, edhe nëse ti e konvertohet në *bitcoin* apo në *yen* japonez. Kështu që, edhe këtë duhet ta kemi të qartë kur të përmirësojmë kuadrin rregullativ për sa u përket kriptomonedhave. Unë mendoj se ne jemi një nga vendet e pakta në Europë, edhe në Europën e Bashkuar, që ka një ligj për sa i përket përdorimit të kryptoaseteve, dhe këtë ligj e ka shumë të mirë, sepse në të gjitha rastet që këtu janë paraqitur subjekte, të cilat kanë pasur si qëllim futjen në tregun shqiptar të kriptomonedhave apo zgjerimin e aktivitetit të tyre në Shqipëri për sa u përket kriptomonedhave, kur kanë parë kuadrin tonë rregullativ dhe kërkesat ligjore, sigurisht që nuk e kanë vazhduar këtë histori, pasi e kanë parë që është e vështirë dhe nuk është aq e thjeshtë, sa për të krijuar problematika të kësaj natyre.

Përdorimi i kriptomonedhave nga individët është diçka që do të vazhdojë dhe, me kalimin e kohës, mund të rritet, por duhet pasur parasysh se këmbimi i monedhës nuk përbën një pastrim parash. Monedha mbetet e papastër, edhe nëse këmbëhet në *bitcoin*.

Faleminderit!

Nirvana Deliu – Faleminderit, zoti Deralla!

Fjalën e kanë zoti Shiqerukaj dhe më pas përfaqësuesja e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, zonja Seknaj dhe më pas përfaqësuesi i OSBE-së. Besoj se mund të përfundojmë këtu, në mënyrë që të mos i tejkalojmë limitet e kohës së takimit.

Artan Shiqerukaj – Faleminderit!

Unë jam Artan Shiqerukaj, jam drejtori i Analizës pranë AIF-së. Do të përpiqem të flas shkurt.

Dua të theksoj diçka, që, ndoshta, nuk është e perceptuar: pastrimi i parave nuk është një vepër që parashkruhet. Në thelb, është pothuajse e pamundur të parashkruhet. Kjo është një gjë shumë pozitive. Në Shqipëri kemi raste dënimesh të formës së prerë me konfiskim 19 milionë euro për një vepër penale të ndodhur para 40 vjetësh. Kjo është një gjë shumë pozitive, nëse janë mekanizmat, kushtet, gjurmimi dhe hetimi; kjo është shumë pozitive edhe për aspektin e kësaj tryeze. Pra, paratë e gjeneruara nga krimi i organizuar apo nga korrupsioni mund të hetohen esencialisht gjatë gjithë jetës së personit që ka kryer krimin apo të familjarëve të tij.

Pjesa e bashkëpunimit

Përveç bashkëpunimit operacional intensiv që kemi me Policinë e Shtetit, (meqenëse nuk i shikoj në tryezë), kemi një bashkëpunim shumë të zgjeruar edhe me SPAK-un, duke përfshirë edhe BKH-në, jo vetëm në kuadër të takimeve të përgjithshme, por edhe për raste konkrete. Besoj se kemi krijuar një traditë shumë të mirë dhe të suksesshme nga kjo histori.

Në lidhje me pjesën e analizave sektoriale, dua të theksoj se ne si AIF kemi 10 vjet që bëjmë të tilla dhe i shpërndajmë për të gjitha institucionet e ndryshme në shtet dhe më duhet ta them se nuk marrim të tilla. Dua të sugjeroj që të bëhen që edhe të marrim ndonjë gjë, sepse mund të kemi shpërndarë 20 analiza strategjike në 7-8 vjetët e fundit, por nuk mbaj mend të kemi marrë një të vetme.

Për sa i përket pjesës së *FinTech*-ut në tërësinë e saj, ka një paradigmë të përgjithshme që pastrimi i parave bëhet me kriptomonedha. Po, është e vërtetë, por edhe për ta lidhur pak me diskutimin e zotit Deralla, keshi është më i pagjurmueshëm sesa një kripto, sepse një kripto lë një gjurmë diku. Po të shikohen në nivel makro, të dhënat që publikon *Channel Analysis* apo të tjera, se çdo gjë është me perspektivë, Shqipëria nuk ka materialitet rajonal, as european dhe asnjë lloj materialiteti në tërësinë e saj. Domethënë, vëllimi i këmbimeve që mund bëhen në Shqipëri, nuk përbën ende ndonjë kërcënim serioz për vendin tonë, dhe ky është fakt. Pavarësisht se ka inteligjencë që tregon, siç e përmendi edhe zoti Deralla, për shembull, se mund të ketë ndonjë zyrë të këmbimit valutor që bën një këmbim në mënyrë të paligjshme, dhe hajde të punojnë të gjithë që ta rregullojmë këtë, sepse është aktivitet që duhet licencuar, por në tërësinë e saj nuk përbën materialitet. Pra, mbase nuk përbën materialitet, edhe sepse krimi i organizuar nuk ka pasur nevojë për këtë, se ka metoda më të thjeshta.

Ne si AIF kemi ndërmarrë disa trajnime; me mbështetjen e ambasadës britanike po bëjmë një trajnim intensiv për hetuesit që merren me kriptomonedhat; në bashkëpunim me kolegët e Policisë së Shtetit nga sektori kibernetik së shpejti, do të kemi edhe një *software* të dedikuar për këtë punë; diçka të ngjashme po bëjnë edhe kolegët në SPAK, por besojmë se i kemi mekanizmat. Megjithatë, duhet të kemi parasysh se *software*-i nuk prodhon asnjë rezultat të tij. *Software*-i kërkon raportime; pa raportime, ai nuk mund të prodhojë rezultate. Nuk ekziston mundësia që nga Shqipëria t'i drejtohem me kërkesa të dikujt, për shembull, t'i themi: m'i jepni këmbimet e të gjithë shqiptarëve, sepse nuk plotësohet kushti i legjitimitetit. Kërkesat për bashkëpunim ndërkombëtar edhe në inteligjencë financiare bëhen bazuar në indicie, nuk pranohen kërkesa të paqarta apo "*phishing*", pra përveç ndonjë rast terrorizmi.

Për sa i përket përdorimit të keshit, normalisht si njësi inteligjence ne do të donim të jetonim një botë pa kesh, sepse e kemi më kollaj ta gjurmojmë, por duhet të kemi parasysh si qytetarë që përfshirja financiare kërkon kohë dhe mundësi. Për shembull, te marketi i lagjes ku unë ble zakonisht, nuk ka kartë. Kështu që, do pak kohë kjo çështje.

Të shkojmë te pjesa e keshit në kufi. Kemi një bashkëpunim të mirë me doganën. Dogana po përgatit disa indikatorë të rinj, por, në fakt, kolegu do ta shtjellojë vetë që kërkohet një rritje e intensitetit të bashkëpunimit me Policinë Kufitare, sepse ka qenë një pjesë që është prekur në raportin e fundit të MONEYVAL-it dhe e sigurt që do të preket edhe tek tjetri, për shkak të ekspozimit gjeografik që ka Shqipëria ndaj lëvizjes së parasë kesh.

Gjithashtu, në raportet tona kemi një tendencë, mbase si mesdhetare, për të theksuar më shumë aspektet negative dhe më pas ato pozitive. Në Shqipëri është bërë shumë progres, dhe gjuha e përdorur nëpër raporte, duhet të evidentojë disi herë pas here... Në fakt, këtu ka materiale që janë prekur, që nuk ka mangësi serioze dhe bëhet fjalë për përmirësime.

Për sa i përket pjesës së deklarimit, duhet të marrim në konsideratë se, me ndryshimin e ligjit në fushën tatimore, deklarimi është 1,2 milionë, nuk është i ulët. Hajdeni ta rregullojmë, të detajojmë formularin, por 1,2 milionë lekë bruto nuk është prag i ulët dhe mund të rregullohet gjithë ditën. Nëse flasim për deklarimin e atyre që njihen si personat të ekspozuar politikisht, kemi një grup mjaftueshëm të madh, ka qenë më i madh dhe u reduktua, për ne është në rregull.

Së fundi, dua të ndalem te disbalanca mes sekuestrimit dhe konfiskimit. Kjo lidhet me qasjen si bëhen hetimet në Shqipëri. Ka vende që në fazën e parë sekuestrojnë ato për të cilat kanë prova, të paktën në dukje që, ose është produkt i krimit, ose është ekuivalent i tij. Ka edhe vende të tjera si ne që bëjnë një sekuestrim shumë më të zgjeruar, duke përfshirë të gjitha pasuritë e personave që po hetohen, dhe më pas këto bien rrugës. Kjo bëhet edhe për qëllim të sigurimit të provave, se mund të dalin edhe të dhëna të reja, por kjo krijon disbalancën, pra i kemi parë rastet që krijojnë një disbalancë.

SPAK-u duket sikur ka një qasje pak më ndryshe; shpeshherë nuk shkon për sekuestrimin e gjithçkaje, por sekuestron vetëm një pjesë. Në lidhje me prokuroritë e tjera, kolegët e prokurorive mund të flasin vetë për këtë. Kaq kisha.

Faleminderit!

Nirvana Deliu – Faleminderit!

Fjalën e ka përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Helidon Bele – Faleminderit!

Unë jam Helidon Bele dhe jam përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, gjithashtu, jam edhe në Drejtorinë e Antitrafikut.

Në fakt, nuk dua të zgjatem, sepse shikoj që duhet të bëjmë ekonomi kohe.

Dua t’i referohem prezantimit të dytë të zotit Shahini në lidhje me transportimin e keshit.

Së pari, ne jemi dakord që penalizimet janë të ulëta dhe duhet të ndryshohen, nëse nuk gabohem, i referohesh fiks nenit 17/1 të ligjit nr. 99/2017, të ndryshuar.

Për sa i përket faktit që duhet bërë një rishikim i Kodit Penal, edhe për këtë jemi dakord, sepse ne duhet ta ndajmë mosdeklarimin nga pastrimi i parave. Në fakt, në terren na takon shpeshherë të shikojmë që disa njerëz ose nga frika ose nga mosdija, pavarësisht se ligji nuk e përjashton, nuk kanë deklaruar, por pastaj janë verifikuar që kanë bërë tërheqje në bankë ose kanë bërë një shitje shtëpie që nuk ishte për pastrim parash. Për shembull, ka disa raste të tjera që shikojmë se ka pastrim parash; ka transportues të keshit. Ne si Drejtori e Përgjithshme kemi kryer trajnime për stafin tonë dhe kemi një manual për mënyrën e intervistimit. Gjithashtu, kërkojmë të rritim sensibilizimin dhe motivimin e stafit. Po, është e vërtetë ajo që tha zoti Boshnjaku se kemi një bashkëpunim shumë të mirë me Policinë Kufitare, por duhet të shikojmë edhe më tej. Mendoj se, ndoshta, nuk duhet t’i shtojmë numrin e punonjësve, por duhet t’i motivojmë ata punonjës që kemi, sepse jam i bindur se, nëse janë të motivuar siç duhet, patjetër që rezultatet janë më të mira, të paktën flas si doganë, edhe me personat që kemi.

Kam thjesht një detaj: pak më parë thatë se nuk ka një institucion ose nuk ka një njësi, e cila të merret me informacionin për pasagjerët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ekziston një njësi e informacionit të pasagjerit në Policinë Kriminale, ku marrin pjesë disa institucione, si: dogana, Agjencia e Inteligjencës Financiare, SHISH-i, SHIU, tani po kërkohet që të përfshihen prokuroria dhe SPAK-u. Kështu që, dua t’ju bëj me dije se ekziston një njësi e informacionit të pasagjerit, ku ne në kohë reale ndajmë të dhëna të personave dhe të ngarkesave, pra në këtë rast të valixheve.

Faleminderit!

Nirvana Deliu – Faleminderit edhe për respektimin kohës!

Ledjon, mendoj të marrim edhe komentet e fundit, më pas mund të bësh një përmbledhje të shkurtër.

Fjala i kaloj zonjës Seknaj.

Ardita Seknaj – Përshëndetje! Jam Ardita Seknaj nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë për Shqipërinë.

Shumë shkurtimisht, thjesht disa reflektime në lidhje me prezantimin dhe më shumë do të fokusohem te pjesa e korrupsionit transnacional në këtë rast. Profesor Kurti përmendi pak ligjin e investimeve dhe shqyrtimin e investimeve të huaja, konkretisht do të doja të përmendja se është shumë e rëndësishme që të gjitha këto janë akte që paraqesin ndërhyrje për arsye të transpozimit që kërkohet, sipas integritetit në Bashkimin Europian, në të njëjtën kohë nuk duhet të harrojmë se është edhe komponenti ekonomik. Në këtë rast operatorët ekonomikë duhet të jenë shumë të përfshirë. Në prezantim ju fokusoheni te shoqëria civile, është e vërtetë, por pothuajse të gjitha temat lidhen me operatorët ekonomikë në vend, kështu që një bashkëpunim shumë më i ngushtë me sektorin privat është themelor. Nga prezantimet e institucioneve të ndryshme doli që mjaft nga institucionet, kanë një bashkëveprim dhe një bashkëpunim të veçantë, por ajo që më mungoi disi, dhe këtë e them me shumë dashamirësi, është ekosistemi, ekosistemi i pastrimit të parave, hartëzimi i të gjithë këtij ekosistemi dhe se cilat palë luajnë rol për këtë.

Po kaloj pak te ligji, që ka të bëjë me shqyrtimin e investimeve të huaja. Pikëpyetja e madhe që na ka ardhur edhe nga puna jonë: nëse duhet të prezantojmë ligje të reja, ndoshta do të duhet të bëjmë gjithmonë edhe një analizë për ta parë nëse kemi aktualisht mekanizma në fuqi, që kanë nevojë të fuqizohen, të cilët realizojnë të njëjtin qëllim, që mund të realizonte një ligj i ri dhe nuk do të krijonte mbivendosje të ndryshme. Për shembull, aktualisht ka një nismë të tillë deputeti në Parlament, pra për shqyrtimin e investimeve të huaja, që besoj se do të diskutohet, por, nga ana tjetër, Shqipëria ka ligje dhe mekanizma në vend që e bëjnë shqyrtimin e këtyre investimeve të huaja. Ndoshta do të duhet të forcohet më shumë aspekti i disa institucioneve, siç mund të jenë AIDA, Banka e Shqipërisë apo institucione të tjera, si Agjencia e Inteligjencës Financiare, që synojnë pikërisht këto elemente. Nuk duhet të harrojmë se nga njëra anë sigurojmë sigurinë kombëtare dhe rendin publik, nga ana tjetër duhet ta bëjmë vendin atraktiv për investimet e huaja dhe, për ta ruajtur këtë balancë, kërkohet të kesh një ndërveprim shumë të rregullt edhe me aktorët e tjerë.

Një moment tjetër, që do të sugjeroja për ta përfshirë, është përdorimi i mallrave të dyfishta, që tregtohen për përdorim civil, por më pas kalojnë si mallra që mund të cenojnë sigurinë, rendin apo mund të jenë subjekt i korrupsionit. Kështu që, ndoshta në këtë drejtim duhet edhe një

vëmendje e shtuar edhe për kontrollet e eksporteve, që ju i kishit përmendur disi, por mendoj se edhe në këtë drejtim duhet një analizë më e mirëfilltë për këtë subjekt.

Në fund fare, ndoshta kjo vjen edhe si pyetje, konstatoj që ju sugjeroni që të regjistrohen subjektet e huaja, të cilat operojnë në Shqipëri. Në dijeninë tonë, subjektet e huaja ekonomike janë subjekt regjistrimi për sa u takon pronarëve përfitues, nëse ka qenë ndryshe, për efekt sqarimi, se krijonte përshtypjen që nuk janë subjekt regjistrimi në këtë drejtim.

Nirvana Deliu – Fjala për ju.

Reinaldo Pipiria – Përsëritet, jam Reinaldo Pipiria, nga Shoqata e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme. Faktikisht nuk e kisha parashikuar që do të bëja një ndërhyrje, por më shumë i provokuar nga pjesë e lehtësisë për të blerë prona kesh. E vërteta është që do të duhet të adresojmë pak pjesën e *gatekeepers*, sot sistemi është i shëndoshur për sa i takon pjesës së *gatekeepers*, pra në të gjitha hallkat tona, që nga ndërmjetësimi i pasurive të paluajtshme, noterët, i kërkojmë *proof of funds* dhe për këtë bëjmë analizat tona. A jemi perfektë?! Jo. Mendoj se në të gjithë diskursin, analizën që bëme dhe të gjithë paraqitjen e kuadrit ligjor, nuk u cekën *gatekeepers*. Pra, sot ne kemi një sistem të tërë, patjetër që kemi publikun që duhet ndërgjegjësuar për pjesën e efekteve negative në ekonomi, por kemi edhe një sektor shumë të mirë, që janë ata që ruajnë, parandalojnë dhe bëjnë analiza. Mendoj që në seancat e tjera duhet të shikohet pak sa i shëndoshë është kuadri ligjor për *gatekeepers*? Janë prodhuar ligje, ndoshta ka nevojë të përmirësohen, të përafrohen pak më tepër me shembujt më të mirë të BE-së.

Në të njëjtën kohë, një tjetër fenomen, pjesë e përpilimit të ligjeve, është vendosja e mjeteve në dispozicion. Sot, të paktën për sektorin tonë, është e vështirë edhe për shkak të mungesës së disa aksesëve në databaza, që të mund të bëjmë analiza të thelluara. Pra, pjesa jonë po mundohemi të bëjmë analiza, por akseset në ASHK, për shembull, do të ishin një ndihmë e madhe, për të analizuar pjesën e transaksioneve për pasuritë e paluajtshme, qoftë edhe historikun, për të kuptuar pak a shumë se çfarë është duke ndodhur. Kështu që, është e lehtë për ta vendosur në kurrizin e *gatekeepers*, por duhet të fuqizohemi me mjete.

Tjetra, që do të doja të sugjeroja, lidhet me sistemin e taksimit në Shqipëri, sidomos mënyra sesi ne merremi me trajtimin e transaksioneve të pasurive të paluajtshme, pjesën e tatimit dhe të gjithë pjesën tjetër, besoj se e bën shumë të vështirë pjesën e luftës së pastrimit të parave. Kështu që, ndoshta një ndërhyrje apo një përafrim, sidomos edhe në ndihmë të strehimit, do të ishte me vend, për të ndihmuar gjithsecilin, për të hequr çfarëdolloj iniciative apo incentive për të shkuar

drejt informalitetit, sepse pastaj informaliteti patjetër që krijon kushte për fenomene të tjera negative në shoqëri.

Faleminderit!

Nirvana Deliu – Ju falënderoj!

Fjala për përfaqësuesin e OSBE-së.

Jonas Kepi – Faleminderit!

Quhem Jonas Kepi, këshilltar rinor në prezencën e OSBE-së në Shqipëri. Po flas shkurt edhe për shkak të minutazhit. Kisha disa pyetje për luftën kundër korrupsionit. Cili është plani për të rritur (është edhe për pjesën e panelit) bashkëpunimin ndërinstitutional për luftën kundër korrupsionit në nivel lokal dhe rajonal? Cilat janë synimet specifike për përmirësimin e politikave për parandalimin e korrupsionit në sektorin publik, duke përfshirë edukimin, nëpunësin civil?

Për pjesën e kriptomonedhave, ne jetojmë në një kohë digjitale, që është një *marvel* i madh, dhe besoj se duhet një transparencë nga komisionet e kërkuara dhe të duhura për ta bërë pjesën e kriptos jo shumë të lidhur me pjesën e korrupsionit, besoj se duhen ndërlidhur të dyja pjesët për të bërë një tranzicion sa më të pastër për pjesën e kriptove që përdorin të rinjtë dhe bizneset. Pra, nuk është fjala që e përdorin gjithmonë për korrupsion kripton, ka metoda plot, por besoj se duhet bërë transparenca e duhur për të parë sesi ky fenomen i ri duhet kërkuar.

Nirvana Deliu – Ju falënderoj, zoti Kepi!

Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen, por edhe për përfshirjen dhe kontributet që dhatë, të cilat janë shumë me vlerë për ne! Ndjesë për të gjithë ata që, për shkak të kohës, nuk kanë mundësi të flasin këtu, por ne jemi të hapur për të mirëpritur çdo koment apo sugjerim edhe nëpërmjet *e-mail*-it apo mënyrave të tjera të komunikimit, pse jo edhe në takime të tjera!

Po ia jap fjalën Ledjonit për një përmbyllje të shkurtër dhe disa reflektime për të gjitha komentet dhe inputet që morëm nga ju. Nëse edhe ti, Skerdian, ke diçka që do të shtosh në fund, mund të flasësh më pas, por shumë shkurt. Unë ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen!

Ledjon Shahini – Faleminderit të gjithëve për komentet!

Do ta nis me aspektin e dokumentit, normalisht dokumenti është shumë më i detajuar, por ne, për shkak edhe të kohës, më shumë prekëm pikat që kanë dalë nga e gjithë analiza e detajuar. Më vjen shumë mirë që u ripërmendën nga të gjithë ju të gjitha ato pika, pavarësisht plotësimeve që mund të ketë nevojë, janë pika që janë në tavolinë. Patjetër, si çdo dokument tjetër strategjik, edhe ky dokument do të ketë nevojë për një plan të detajuar, ku këtu futen në lojë të gjitha ato që

u përmendën këtu si iniciativa që janë në proces, pavarësisht se ne kemi bërë një fotografim të situatës deri në raportin e fundit të BE-së, të vitit 2024, dhe jemi munduar që të përfshijmë çdo dokumenti që na është vënë në dispozicion dhe që mendojmë se ka qenë gjithëpërfshirës. Në këtë aspekt, të gjitha proceset që do të ndodhin, duke qenë se edhe kjo do të jetë një iniciativë që do të ketë një periudhë implementimi dhe do të ketë masa konkrete të përfshira në plan veprimi, patjetër që të gjitha këto do të gjejnë vend në komponentët respektivë. Këtu dua të theksoj, sidomos pjesën e strategjisë së Agjencisë së Inteligjencës Financiare. Ne e kemi parë me shumë me vëmendje, dhe dua të theksoj se ka një ndërveprim shumë të mirë të gjetjeve dhe masave që janë vendosur në strategji me atë që gjykohej se do të jetë pjesë përbërëse, por patjetër që do të ketë edhe masa më konkrete të shtuara nga kjo gjë. Për sa i përket pjesës së të gjithë komponentit, duhet të kemi parasysh se ky është një material, flasim vetëm për komponentin 4 të një shtylle që do të ketë një ndërlidhje me komponentët e tjerë, duke marrë një pasqyrim më të plotë edhe të luftës me korrupsionin dhe me komponentë të tjerë që do të përfshihen në të gjithë shtyllën.

Për disa nga gjërat specifike që u përmendën, sepse shumica ishin rekomandime apo informacione që ne do t'i shohim me shumë vëmendje për t'i pasqyruar në mënyrë më konkrete, në qoftë se në dokumentin e detajuar nuk janë prekur, do të doja të ndalesha pak te pjesa e atyre që ishin pika konkrete. Kur ju referova pjesës së doganave të institucioneve, nuk e kisha për një pikë doganore, por e kisha për ndërveprimin, pra, në qoftë se një njeri futet nga toka dhe del nga ajri apo nga deti. Për këtë pjesë, me atë që kemi konstatuar, vëmë re se 3 sistemet e ndryshme që ekzistojnë, sistemi TIMS, sistemi i doganave dhe i aeroportit, nuk e kanë shkëmbimin e informacionit në kohë reale, ndoshta jemi jo të saktë, por është për t'u diskutuar dhe për t'u parë.

Për pjesën e regjistrimit të kompanive të huaja, sepse ndoshta është thënë gabim, se janë të regjistruara, por më shumë lidhet në kuadrin e pronarit përfitues. Për sa i përket sistemit të kriptos, meqenëse u përmend disa herë, të gjitha ato që u thanë janë shumë të sakta, por duhet të kemi parasysh se, duke qenë një treg i ri dhe për Shqipërinë është akoma më i ri, duhet të kemi parasysh se ekonomia e Shqipërisë është vetëm 0,02% e GDP-së globale dhe, në qoftë se ne do të kemi ndonjë luhatje të menjëhershme, ndoshta mund të na godasë, se mund të diskutojmë vende si Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të tjera, por ato janë 25% e GDP-së globale, dhe nuk influencohen. Ne këtu kemi edhe atë që shpesh e quajmë qëllime dashakeqëse nga vendet e tjera, që ndoshta mund të tentohen të jenë kanale për t'u përdorur, sidomos kur flasim për një sistem *blockchain*, që nuk ka një institucion qendror që e rregullon këtë gjë.

Besoj se këto ishin gjërat specifike që u diskutuan apo pyetjet, ndërsa sa u përket të gjithë të tjerave... Për sa i përket pjesës së databazave, sepse u përmend disa herë, patjetër që është shumë e rëndësishme ruajtja e konfidencialitetit dhe, në këtë kuadër, prandaj u përmend disa herë aspekti i indikatorëve të riskut. Pra, në qoftë se ne arrijmë të ngremë sisteme që jo detyrimisht përcaktojnë se cili është individ apo subjekti, por përcaktojnë nëse është në risk apo jo dhe më pas kalojmë te faza tjetër. Pra, nuk është e thënë që duhet të kesh informacionin që të përcaktosh se me kë ke të bësh, sepse sot metodat e informatikës janë të avancuara që e zgjidhin këtë gjë. Këto kisha dhe do të përpiqemi, siç e thamë, që çfarë u tha këtu ta shikojmë, të gjitha dokumentet që ju përmendëm t'i rishikojmë edhe një herë, për të bërë reflektimet e duhura dhe do t'ju falënderoja shumë për të gjitha komentet me vlerë që u dhanë!

Nirvana Deliu – Shumë faleminderit! Skerdian, ke diçka për të shtuar, apo ta quajmë të mbyllur?

Skerdian Kurti – E quajmë të mbyllur.

Nirvana Deliu – Në rregull, zoti Xhafaj, fjala për ju.

Fatmir Xhafaj – Nuk do t'ju marr kohë. Kjo është tryeza e shtatë dhe unë flas për herë të parë. Nuk e kam si rregull, por, meqenëse kolegët sot nuk janë këtu, për shkak të një impenjimi tjetër po kaq të rëndësishëm, jam i detyruar t'i them dy fjalë si mikpritës i kësaj godine, por edhe i vetë iniciativës dhe reformës që kemi ndërmarrë. Në fakt, jemi vetëm dy persona që kemi qenë në të shtata tryezat, unë edhe zonja që ka shoqatën e inxhinierëve, por i vetmi ndryshim është se ajo ka folur në të shtata tryezat, ndërsa unë vetëm një herë.

Së pari, dëshiroj t'ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe kontributet e çmuara! Personalisht kam mbajtur shënime shumë të mira nga ato që u thanë, të cilat janë një mundësi e mirë për të reflektuar dhe për t'i reflektuar në dokumentin analitik dhe më pas për t'i parë si indicie në lidhje me planin kombëtar të veprimit që do të duhet të hartohet. Dua të bëj një vlerësim për të gjithë ekspertët që kanë punuar për këto komponentë, e gjithë reforma është në tri shtylla, mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit, ka 15 komponentë dhe mbi 20 nënkomponentë përbërës. Ky grup që ka punuar pikërisht për këta komponentë, meriton vlerësimet më të mira për angazhimin, për impenjimin që në një kohë kaq të shkurtër ka arritur të japë një produkt të kësaj natyre. Dëshiroj të falënderoj Nirvanën, si përfaqësuese e shoqërisë civile, që moderoi kaq mirë këtë tryezë, ku zakonisht ne jemi mësuar të shikojmë politikanë aty, por Nirvana na sfidoi me një moderim shumë të qetë dhe profesional së bashku me të dy kolegët e saj, të dy

profesorët e respektuar, profesor Skerdin dhe profesor Shahinin, për kontributin dhe prezantimin! Besoj se është mbajtur në vëmendje nga pjesëmarrësit në këtë tryezë se ky është thjesht një draft i dokumentit analitik, nuk është një dokument final. Aktualisht është një draft, i cili është produkt i punës së ekspertëve, nuk është produkt i punës së komisionit. Komisioni është këtu pikërisht për ta lehtësuar, për ta koordinuar dhe për ta drejtuar këtë proces, natyrisht, për të parë, për të shqyrtuar dhe për të miratuar dokumentin final që do të vijë në tryezën e tij, për shkak se i gjithë ky proces është ndërtuar nga ekspertët, që vijnë nga shoqëria civile, nga universitetet publike dhe jopublike, nga institucionet e pavarura dhe komuniteti i biznesit. Ky është një proces konsultimi për vlerësim, për gjetje dhe propozime të reja. Nuk përfundon këtu ky proces, dhe dëshiroj t'ju bëj një lutje, jeni të hapur dhe jeni të mirëpritur që në vazhdim të mund të sillni komentet që keni, me gjetjet dhe propozimet e ndryshme, që e pasurojnë këtë dokument, i cili është hapi i parë i një procesi kaq të madh, i një reforme kaq të gjerë dhe komplekse, për shkak se nga ky dokument do të shkojmë tek ajo që e quajmë “Plani kombëtar i veprimtari”, ku do të përcaktojmë masat konkrete legjislative, institucionale për ndërhyrje, jo thjesht në legjislacion, por kryesisht në procesin e zbatimit të ligjit.

Dua të dal te një problem që u diskutua gjatë. Besoj se kemi bërë hapa të mirë në shumë fusha, edhe në këtë fushë për të cilën po flasim këtu, që është një fushë pak delikate, sidomos vitet e fundit ka hapa shumë të mirë pozitivë. Edhe nga pikëpamja e legjislacionit unë bie dakord që kemi një legjislacion të mirë, standarde përgjithësisht ndërkombëtare të vlerësuara pozitivisht edhe nga organizmat e pavarura ndërkombëtarë, që operojnë në këtë sektor, por problemi që kemi, si në shumë fusha të tjera, është zbatimi i ligjeve dhe efienca e institucioneve. Ashtu siç kemi shumë ligje, është e vërtetë që kemi edhe shumë institucione, siç e patë, një pjesë e tyre janë këtu sot, por ajo që do të duhet të na preokupojë është se sa efiente janë këto institucione, secili në fushën e vet dhe në ndërveprim me njëri-tjetrin dhe se sa eficient është zbatimi i ligjit. Ky është fokusi ynë: se si të mund të bëjmë ndryshimet dhe transformimet e nevojshme, dhe këtu bie dakord me atë që tha Besforti se nuk është qëllimi që të bëjmë detyrat e radhës në procesin e integritetit në BE, por qëllimi është sesi t'i sjellim standardet më të mira europiane në jetën tonë të përditshme, në shoqërinë tonë, në mënyrën sesi sillen dhe punojnë institucionet e vendit tonë. Kjo është shumë e rëndësishme. Këto janë 3 fusha që prekin drejtpërsëdrejti interesat e qytetarëve, shtetin e të drejtës dhe të ardhmen e vendit, që, natyrisht, afektojnë pozitivisht edhe në procesin e integritetit në BE. Gjithsesi, unë nuk jam këtu për të folur sot, dhe do t'i qëndroj besnik kësaj që kemi përcaktuar në fillim se deputetët, politikanët nuk janë këtu për të folur, por për të mbajtur shënim dhe ne jemi

duke mbajtur shënim me shumë respekt për atë që përfaqëson secili nga ju, për kontributet tuaja, për t'i reflektuar këto më pas në një proces të dytë në punën tonë.

Edhe një herë shumë faleminderit që ishit këtu dhe shumë faleminderit për kontributet! Dëshiroj edhe një herë ta theksoj se jeni të mirëpritur për ta vazhduar këtë ndërveprim me grupin e ekspertëve.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit